



Pasuria e diversitetit

HISTORIA KULTURORE E —
PAKICAVE NË MAL TË ZI —



Centar za građansko obrazovanje
Centre for Civic Education



Crna Gora
Ministarstvo pravde,
ljudskih i manjinskih prava



Podgoricë, 2021.

Shtëpia botuese:

Qendra për Arsimim Qytetar (QAQ)



Centar za građansko obrazovanje
Centre for Civic Education

Për botuesin:

Daliborka Ulareviq

Redaktorët:

Rade Vujoviq dhe Milosh Vukanoviq

Autori/ja:

Sait Shabotiq, Lilana Bajçetiq, Marko Radojeviq, Valentina Knezheviq, Tatjana Zambata, Martina Saulaçiq Lompar, Marija Saulaçiq, Igor Raduloviq, Vesna Kovaçeviq, Zvezdana Lakiq

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Monika Mrnjaçeviq

Nikola Gjonoviq

Dizajni dhe produksioni:

Qendra për Arsimim Qytetar (CGO)

Qarkullim:

24

Publikimi “*Pasuria e Diversitetit - Historia Kulturore e Pakicave në Mal të Zi*” u realizua në kuadër të projektit me të njëjtin emër, të cilin Qendra për Arsimim Qytetar (QAQ) e zbatoi në bashkëpunim me Shoqatën e Mësuesve të Historisë së Malit të Zi (HIPMONT), me mbështetje financiare nga Ministria e Drejtësisë, të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet si qëndrim zyrtar i Qeverisë së Malit të Zi, QAQ ose Hipmont.

Përmbajtja

5

Metodologjia e mësimdhënies së historisë kulturore të pakicave dhe bashkësive të pakicave kombëtare në Malin e Zi

6

Sait Sh. Shabotiq: Mali i Zi nga viti 1851 deri në vitin 1914

19

Mr Lilana Bajçetiq: Vizatime nga jeta e përditshme e popullsisë myslimane Plevla (XIX sh.-fillimi i XX sh.)

34

Marko Radojeviq: Afirmimi i bashkëjetesës dhe tolerancës - Burrëria

39

Valentina Knezheviq: Shqiptarët - origjina, mënyra e jetesës dhe rruga për pavarësi

47

Sait Sh. Shabotiq: Shqiptarët në Mal të Zi

56

Tatjana Zambata: Marina e Bokës

64

Martina Saullaçiq Llompar, Marija Saullaçiq: Festivali i Shën Trifunit – mbrojtësit të qytetit dhe Vëllazërisë së marinerëve të Bokës

72

Igor Raduloviq: Edukimi i popullsisë rome në Mal të Zi

78

Igor Raduloviq: Historia e Hebrenjve në tokën e Malit të Zi

85

Vesna Kovaçeviq, Zvezdana Llakiq: Mali i Zi-takim multietnicitetesh

Metodologjia e mësimdhënies së historisë kulturore të pakicave dhe bashkësive të pakicave kombëtare në Malin e Zi



Gjatë zhvillimit të tij evolucionar, njerëzimi lëvizi në drejtime të ndryshme të kushtëzuara kryesisht nga faktorë natyrorë, duke krijuar ngadalë por me siguri qytetërimet e para - kulturat e Lindjes së Lashtë të cilat, përmes Kretës dhe Mikenës, do të rezultojnë në kulturën Greke dhe Romake (antike) si themele të civilizimit evropian.

Do të jetë themeli që do të qëndrojë si bazament i shtëpisë sonë - Duklës, Zetës dhe Malit të Zi, në historinë e saj të vështirë dhe të pasur shumë shekullore. Lufta për liri (vetëm një njeri i lirë është një njeri i lumtur) dhe identiteti personal në një zonë historikisht “të lëkundur”, do të rezultojë në ndikime të ndryshme civilizuese, fetare, kombëtare, kulturore, duke krijuar një pasuri të diversitetit. Kështu, falë mbijetesës edhe më të vështirë dhe këmbëngulëse të Malit të Zi gjatë shekujve, e kaluara e vështirë do të rezultojë në frytet më të bukura, multikulturalizmin e civilizimit të tij, i cili është dhe sot tipari më i bukur i botës moderne. Duke u ndodhur dhe gjeografikisht në qendër të civilizimit – Mesdheu, Mediterraneum (Media - qendër; Terra - vend) si vend i vogël ku do të “puthen” civilizime të ndryshme - Greke, Romake, Bizantine, Osmane, Venedikase, Evropiane moderne - duke krijuar një peizazh kulturorë të pazakontë dhe unik.

Bashkësitë e pakicave, kryesisht autoktone, me karakteristikat e tyre, janë pjesë e pasurisë së saj kulturore, përkatësisht historisë së saj kulturore. Prandaj, ky projekt i ka vendosur vetes qëllimin që përmes njohjes me segmentet e ndryshme të trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale të pakicave të Malit të Zi, të tregojë vlerën e tyre në mbushjen e siperfaqes së rrethit të përgjithshëm të historisë kulturore malazeze. Kjo nevojë tregohet si e domosdoshme, veçanërisht nëse kemi parasysh përhapjen e ekstremizmit fetar dhe kombëtar, dëshmitarët e të cilit jemi në tri dekadat e fundit. Kështu, kufijtë e njerëzëve, për fat të keq, bëhen kufij midis njerëzve. Por kufijtë janë aty për t’u kaluar, apo jo?

Abuzimi i fakteve, të historisë së përgjithshme si dhe asaj kulturore, e përdor larminë si bazë për kundërshtim, e jo për pasuri dhe harmoni. “Mendjet dembele” të cilat nuk munden dhe nuk dinë ta vërejnë peizazhin e rrallë të pasurive kulturore të Malit të Zi (bazës dhe pakicave) e shohin atë si një problem, në vend që ta shohin si një thesar që duhet të ruhet, zhvillohet dhe ushqehet, ndër të tjera, nga të tilla projekte. Sfidat në zhvillimin e tyre janë të shumta, gjë që kërkon planifikim studimor, qasje multiperspektive ndaj temave, të cilat ndjekin fakte historike të konfirmuara nga burime historike, kronologji të qartë dhe precize me mjete adekuate metodologjike dhe arsimore, duke respektuar parimet pedagogjike dhe psikologjike.

Gjatë punës disa mujore në projekt, nga planifikimi deri tek zbatimi i segmenteve të ndryshme, unë veçanërisht do të doja të theksoja pjesën në të cilën fituesit e përzgjedhur pranuan sugjerimet e dhëna për përmirësimin e përgatitjeve, në përputhje me rekomandimet e listuara tashmë. Kështu, fjalët bashkëpunim dhe respekt reciprok u bënë baza e të gjithë projektit, nëpërmjet përgatitjeve dhe temave të ndryshme pati synimin për të qenë udhëzues dhe ndihmë për edukatorët e shkencave humane sociale në vendin tonë me mesazhin “Mali i Zi është kopsht parajsor ku puthen civilizime të ndryshme.”

Rade Vujović

Kyetaari i Shoqatës së profesorëve të historisë të Malit të Zi (HIPMONT)



Sait Sh. Shabotiq

Mali i Zi nga viti 1851 deri në vitin 1914

MËSUESI	Sait Sh. Shabotiq		
TEMA E ORËS	Mali i Zi nga viti 1851 deri në vitin 1914		
NJËSIA MËSIMORE	Një orë e mësimit (45 min)		
LËNDA MËSIMORE	Historia	KLASA	VIII
QËLLIMET	<p>Edukative :</p> <p>Nxënësit do të kuptojnë informacionin bazë për komunitetin kombëtar boshnjak-myslimane në Mal të Zi dhe Nikshiq në kontekstin historik; Nxënësit do të vlerësojnë faktet në lidhje me kulturën dhe arritjet kulturore të myslimane/boshnjakëve; dallimet gjuhësore, traditat dhe simbolet arkitektonike;</p> <p>Nxënësit do të përcaktojnë dhe analizojnë konceptet e reja – stereotipi; dallimi i identitetit; besnikëria qytetare.</p> <p>Arsimore:</p> <p>Nxënësit do të zhvillojnë ndjenjën për krijimin e mardhënieve harmonike në komunitet; do të zhvillojnë tolerancën ndaj dhe midis anëtarëve të grupeve të ndryshme etnike, bashkësive fetare dhe popujve të pakicave; qëndrimi pozitiv dhe këmbulje ndaj punës, saktësisë dhe përpikmërisë në mësim.</p> <p>Funksionale:</p> <p>Nxënësit do të zhvillojnë kujtesën, mendimin kritik, aftësitë e interpretimit verbal dhe pavarësinë në punë.</p>		



REZULTATET E MËSIMIT	Nxënësit do të kuptojnë dhe vlerësojnë nevojën për bashkëjetesë; Do të jenë në gjendje të njohin stereotipet dhe paragjykimet, si nevojën dhe mënyren për ti tejkaluar ato; do të zhvillojnë tolerancën dhe vetëdijen qytetare, si dhe përgjegjësinë ndaj kulturave dhe komuniteteve të tjera të ndryshme.
FORMA DHE METODA E PUNËS NË ORË	Verbal - tekstual:-Prezantim me gojë (Shpjegim dhe përshkrim), Punim në burim historik; Punë me tekste gazetarie. Metoda dialogologjike (bisedë heuristike, diskutim). Ilustruese - demonstrative:- Prezantimi në projektor; Punë me fotografi si burim historik.
MJETET MËSIMORE	Libri shkollor, Harta historike (Zhvillimi teritorial i Malit të Zi), laptopi, projektori, ekran projeksoni, tabelë shkrimi.
LITERATURA	Ž. M. Andrijašević/S. Šabotić/D. Papović/S. Drobnjak, Istorija 8, udžbenik za osmi razred osnovne škole, ZUNS, Podgorica 2019; Ž. M. Andrijašević&Š. Rastoder, Istorija Crne Gore od najstarijih vremena do 2003, Podgorica 2006; Nikšić, monografija, Zagreb 1972; P. Šobajić, Nikšić-Onogošt, Beograd 1939; B. Hrabak, Nikšić do početka XIX vijeka, Beograd 1997; S. Drobnjak & S. Šabotić, Muslimansko-bošnjačko stanovništvo Onogoškog-Nikšićkog kraja od 1477-2003, Podgorica 2005; Istorijski leksikon Crne Gore, knj. I-V, Podgorica 2006; L. Valenta, Upoznajmo se, Metodčki priručnik za nastavnike, 2008; Moje vrijednosti i vrline – razvoj socijalnih i emocionalnih vještina učenika i učenica, Priručnik za nastavnike i nastavnice u osnovnoj školi, Podgorica 2018;
KORRELACIONI	Korrelacioni brenda lëndës: VII klasë – Arabët dhe islami, lufta e kryqëzatave; VIII klasë. Shfaqja dhe përhapja e Islamit dhe kulturës Islame në Mal të Zi; Krimet kundër popullsisë myslimane. Korrelacioni me lëndët e tjera: Gjuha malazeze-serbe, boshnjake dhe kroate - intervista si metodë për mbledhjen e të dhënave; Kultura e artit - dekorime në gurë varresh, ndërtime, poster; Gjeografia - përkatësia administrative e zonës; Edukimi qytetar - tejkalimi i paragjykimeve.



Përmbajtja (rrjedha) e punës

Përgatitja e nxënësit - hyrje në temë ose njësi

RRJEDHA E ORËS:	Aktivitetet e mësuesit
AKTIVITETI I HYRJES	<ul style="list-style-type: none">▪ Regjistrimi i rezultatatit të orës; regjistrimi i nxënësve që mungojnë; Ftesë për nxënësit të përgatisin pajisjet për orë▪ <u>Motivimi</u>: Mësuesi u drejtohet nxënësve me kërkesë për të shkruar fjalë në tabelë që i shoqëron ata me Islamin dhe myslimanët.▪ Tregon një histori të shkurtër për fatin historik të qytetit, për mënyrën se si gjatë gjithë historisë ai u përkiste popujve të ndryshëm që lanë dëshmi të ndryshme të pranisë së tyre në tokën e tij.▪ Përcakton dhe thekson qëllimet e orës.▪ Bazuar në njohuritë e fituara dhe të miratuara më parë, mësuesi u bën nxënësve pyetje të shkurtra me qëllim motivimi ku përmjet prezantimit kalon në njësi të re mësimore dhe realizimin e rezultateve arsimore.▪ Nëpërmjet laptopit lëshon fotografitë dhe pyetjet (Bashkangjitja nr. 1).▪ 1. <i>Cila ngjarje historike është në foto?</i> (Puna e pjesëmarrësve në Kongresin e Berlinit).2. <i>Çka fitoi dhe arriti Mali i Zi në atë Kongres?</i> (Arriti konfirmimin ndërkombëtar të pavarësisë dhe zgjerimit territorial).3. <i>Cilat grupe fetare jetonin në Malin e Zi para dhe cilat pas Kongresit të Berlinit?</i> (Para Kongresit të Berlinit, jetuan anëtarët e komunitetit fetar Ortodoks, dhe pas kësaj, anëtarët e bashkësive Katolike dhe Islame).
AKTIVITETI KRYESOR	<p>4. <i>Në foton e dhënë, a i njihni njerëzit me veshje që janë të ndryshme nga ajo tradicionale malazeze? Kush janë ata dhe çfarë titujsh mbanin? Mundohuni të njihni mesazhin e figurës.</i> (Fotografia tregon, ndër të tjerat, udhëheqësit fetarë të popullsisë Ortodokse, Katolike dhe Myslimane në Mal të Zi - Metropolit, Peshkopi dhe Myftiu. Mesazhi i figurës është respekti reciprok).</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Mësuesi vazhdon me prezantimin gojor të përqendruar në informacionin mbi numrin e popullsisë Islame në Mal të Zi dhe Nikshiq pas Kongresit të Berlinit, duke treguar procesin historik në të cilin njerëzit u bënë numerikisht më pak se popullsia Ortodokse. Prezantimi vazhdon me historinë e emërimit të asaj popullsie me qëllim të nxjerrjes në pah konceptin e stereotipave dhe paragjytimeve, dmth. çfarë nënkuptojnë ata në ndërtimin e qëndrimeve dhe mendimeve ndaj anëtarëve të njerëzve që referohen në Malin e Zi me terminin "njerëz të pakicës" (mësuesi do të përdorë termin "gardh në kokë" si ilustrim, duke u përpjekur ti sjellë nxënësit më afër atij koncepti).



- Lexon vendimet e Kongresit të Berlinit në lidhje me Malin e Zi dhe popullsinë e fesë Islame në të **(Bashkangjitja nr. 2)**.
 1. *Tregoni qëndrimin tuaj për vendimet e mësipërme të Kongresit të Berlinit?*
 2. *Cilat të drejta të njeriut theksohen në vendimet e Kongresit të Berlinit?*
 3. *A jan përcaktuar vendimet në Kongresin e Berlinit për çështjen e trashëgimisë kulturore?*
 - Me ndihmën e laptopit fillon të shfaqë fotografitë në ekran projeksioni (porta kryesore e qytetit të Nikshiqit; Dyqani i Karvaneve të Nikshiqit, Muri; Dorëzimi i Nikshiqit) dhe lexon një tekst nga Ludvig Kuba në lidhje me Nikshiqin në perandorinë osmane **(Bashkangjitja nr. 3)**.
 - Vazhdon prezantimin për monumentet e mbetura të trashëgimisë islamike-orientale në Nikshiq dhe rendit ato më të rëndësishmet: xhamia e Haxhi Ismailit; Ura e Haxhi Ismailit në Dukël; Muri; Nishani në varrezat e Bisticës; Shtëpia e Mekiqit në rrugën e Karagjorgjes.
 - Bën pyetje:
 1. *Çfarë konkludoni bazuar në tekstin e lexuar dhe ilustrimet?*
 2. *Zgjedhni dhe emërtoni monumentet e sotme kulturore dhe historike në Nikshiq që klasifikohen si trashëgimi kulturore dhe historike të Boshnjakëve / Myslimanëve?*
 - Rendit nxënësit në grupe sipas ndarjes që bëri orën e kaluar (5x5).
 - I jep detyrat që ka përgatitur për grupet. Emëron “udhëheqësit” e grupeve dhe shpërndan fletët me detyra të përcaktuara në grupe **(Bashkangjitja nr. 4)**. Përcakton kohën për të përfunduar detyrën. Inkujaron grupet të bashkpunojnë për rezultat më të mirë. *Për të zgjidhur detyrën, mësuesi përdor disa teknika “urat dhe muret”, “të njëjta dhe të ndryshme”, “intervistë”, “poster”.* Bazuar në atë që është shkruar, nxënësit nxjerrin përfundim në lidhje me ndryshimin nëse është një avantazh apo një disavantazh i një shoqërie.
 - Fton udhëheqësit e grupeve të paraqesin zgjidhjen përfundimtare të detyrës.
 - Kryen një përmbledhje të shkurtër të përmbajtjes.
 - Bën vlerësimin e orës:
 - Çfarë kemi mësuar në këtë orë?
 - Si kemi bashkpunuar?
 - Si jemi ndjerë?
 - Çfarë mund të shtohet për ta bërë orën dhe të mësuarit më të mirë dhe më efikase?
 - Cakton detyrat e shtëpisë (Opsional):
- Nga konceptet e miratuara, emrat e objekteve të trashëgimisë dhe njohurit e tjera nga historia, bëni një fjalëkryq ku zgjidhja përfundimtare do të jetë „Diversiteti është pasuri”; Shkruani një esej për „Diversiteti është pasuri“!



Aktivitetet e nxënësit

-Pjesa e hyrjes në orë (5-7 min)

- Marrin pjesë në regjistrimin e nxënësve që mungojnë; Ata përgatisin pajisjet për punë në klasë
- Dëgjojnë me kujdes prezantimin e mësuesit
- Nxënësit individualisht dalin para tabelës dhe shkruajnë shoqatat e tyre
- Nxënësit mendojnë, u përgjigjen pyetjeve të mësuesit, zgjidhin libra me figura, tregojnë në hartën historike dhe lidhin ato që kanë mësuar.

-Pjesa kryesore e orës (33 min)

- Nxënësit dëgjojnë me kujdes (Frontal)
- Vëzhgojnë në tabelë numrin e banorëve të fesë islame dhe ortodokse në projektion; Paraqesin grafikisht; krahasojnë, përfundojnë
- Shkruajnë në fletore definicionin e paragjykimit (Paragjykimet - janë qëndrime që logjikisht janë të pajustificuara dhe të pabazuara (nuk kanë bazë të vërtetë), ato janë shumë emocionale dhe vështirë të ndryshojnë. Më të zakonshmet janë paragjykimet etnike dhe racore (zezakët, hebrenjtë...).Ata janë jashtëzakonisht negativë! Këto janë qëndrime negative të drejtuara kundër: fenomeneve, individëve, grupeve. Është një mendim apo gjykim që nuk bazohet në fakte, mendimi krijohet pa të dhëna dhe njohuri të mjaftueshme. Personi nuk vë në dyshim këtë pikëpamje.
- Shkruajnë definicionin e stereotipit (Stereotipet - janë ide banale dhe të gabuara për disa kombe dhe popuj. Ndryshe nga paragjykimi, mund të ndodh edhe stereotipi pozitivë. Është mënyrë e thjeshtëzuar e të menduarit rreth fenomeneve dhe grupeve të njerzve. Opinioni bazohet në gjysë informacionesh.
- Përgjigjen në pyetjet e bëra; Me kritikë sjellen ndaj burimeve historike dhe pretendimeve të tija. Nxënësit dëgjojnë me kujdes, mendojnë, vlerësojnë, përgjigjen, shkruajnë në fletore.
 - Marrin pozicione të reja në klasë;
 - Konsultohen dhe bien dakord në grup;
 - Bëjnë ndarjen e materialit që e kanë në dispozicion; Zgjedhin pjesët e tekstit; kërkojnë me ndihmën e internetit; me shkrim u përgjigjen pyetjeve që gjenden në tekst; definojnë thelbin, kuptimin dhe mesazhin e materialit të zgjedhur.

"Udhëheqësit" e grupeve paraqesin zgjidhjet e tyre me komentet e anëtarëve të tjerë të grupit.

-Pjesa përfundimtare e orës (5 min)


- Komentojnë;
- Shkruajnë në fletore detyrën e shtëpisë.

Vetëvlerësimi i orës së mbajtur:


Bashkangjitjet




Bashkangjitja nr. 1:



Puna e pjesëmarrësve në Kongresin e Berlinit



Zhvillimi territorial i Malit të Zi nga fundi i shekullit të XV deri në v.1918

Udhëheqësit fetarë në Cetinë në v. 1910, gjatë shpalljes së Malit të Zi si Mbretëri 



Pyetjet:

1. Cila ngjarje historike është në fotografi?
2. Çfarë arriti dhe fitoi Mali i Zi në atë kongres?
3. Cilat grupe fetare kanë jetuar në Mal të Zi para dhe cilat pas Kongresit të Berlinit?
4. Në foton e dhënë, a i njihni njerëzit me veshje që janë të ndryshme nga ajo tradicionale malazeze? Kush janë ata dhe çfarë titujsh mbanin? Mundohuni të kuptoni mesazhin e figurës.

Bashkangjitja nr. 2:

Në territorin e Malit të Zi, regjistrimi i parë me karakteristikat e regjistrimit modern u krye në mes të vitit 1879 me urdhërin e Princ Nikollës. Njëzet vjet më vonë në Mali të Zi dhe Nikshiq ishin:

Numri i popullsisë në 1898			
	ortodoksë	mysliman	katolik
Mali i Zi	140.000	12.051	7.500
Nikshiq	1.800	165	?

Vendimet e Kongresit të Berlinit drejtuar Malit të Zi

Neni XXVI: Pavarësia e Malit të Zi do të pranohet nga Porta e Lartë dhe të gjitha palët e Larta kontraktuese që nuk e kanë pranuar akoma.

Neni XXVII: Palët e larta të kontratës bien dakord për kushtet në vazhdim: ... Liria dhe kryerja e të gjitha riteve fetare do të sigurohet për të gjithë qytetarët e Malit të Zi dhe të huajt ...

Neni XXIX: Tivari dhe brendësia e tij bashkohet me Malin e Zi ... Mali i Zi ka liri të plotë të lundrojë në lumin Buna ... Mali i Zi nuk do të ketë anije luftarake ose flamuj detarë.

Porti i Tivarit dhe të gjitha ujërat e Malit të Zi do të jenë të mbyllura për anijet luftarake e të gjitha kombeve...

Neni XXXII: Ushtria Malazeze është e detyruar të largohet nga territoret në pronësi të Principatës jo më vonë se njëzet ditë nga dita e ndryshimit të traktatës së ratifikuar. Ushtria turke do të largohet nga territoret që i përkisnin Malit të Zi me këtë marrëveshje brenda njëjtës periudhë.

Neni XXXIII: Meqenëse Mali i Zi duhet të marrë një pjesë të borxhit publik osman për territoret e reja të caktuara nga traktati i paqes, përfaqësuesit e forcave të Kostandinopojës do të përcaktojnë shumën e asaj pjese në marrëveshje me Portin e Lartë me bazë ligjore ...

Pyetjet:

1. Shprehni qëndrimin tuaj mbi vendimet e mësipërme të Kongresit të Berlinit?
2. Cila e drejtë e njeriut theksohet në vendimet e Kongresit të Berlinit?
3. Me vendimet e Kongresit të Berlinit a është definuar çeshtja e trashëgimisë kulturore?

▣ Bashkangjitja nr. 3: Bashkangjitje figurash:



↗ Pamja e Nikshiqit modern



Porta kryesore e qytetit të Nikshiqit ↗



↗ Bedemi i Nikshiqit sipas vizatimit të A. Evansa



↗ Dyqani i karvanëve në Nikshiq



↗ Bedemi i Nikshiqit sipas vizatimit të A. Evansa

Shkrimet e Ludvig Kuba për Nikshqin e vjetër

Dëshmi interesante për pamjen e një numri ndërtesash të vjetra nga periudha osmane, u la nga gjeografi dhe muzikologu çek Ludvig Kuba, i cili vizitoi Nikshiqin dhjetë vjet pasi qyteti kaloi në duart e malazezëve. Ai shkroi për pamjen e kasabës së Nikshiqit: „Pasi pashë rrugët e drejta të qytetit të ri, i cili u ndërtua pas luftës së fundit dhe ndërtimi i të cilit të kujton qytetin e pakëndshëm të Mirkos në Podgoricë, hyra në rrënojat e Nikshiqit të vjetër turk. Ndërtesat e vjetra myslimane interesante të rrënuara veprojnë me hijeshi të perezistueshme. Çati të ulëta, me pllaka haremesh, dyqane dhe kafene, ballkone prej druri, muza në dritare katrore, mure të spikatur dhe ndonjëherë të zbukuruara, ndërtesa të shkatërruara prej guri, dyer të shkreta pa porta, të gjitha gjysma të prishura, gjysma të ruajtura, gjysma me bar, gjysma myshk. Ky është përafërsisht qyteti i vjetër i Nikshiqit.“

Burimi: Ludvig Kuba, *U Crnoj Gori*, CID, Podgorica 1996.

Pyetjet: ?

1. Çfarë konkludoni bazuar në tekstin e lexuar dhe ilustrimet që patë?
2. Zgjedhni dhe emërtoni monumentet e sotme kulturore dhe historike në Nikshiq që klasifikohen si trashëgimi kulturore dhe historike të Boshnjakëve/Myslimanëve?

▣ Bashkangjittja nr. 4: Detyrat për grupe:

Grupi I: Xhamia Haxhi Ismaili në mahallën Gruda si monument i trashëgimisë kulturore dhe historike të Boshnjakëve/Myslimanëve të Nikshiqit

Detyra: Lexoni me kujdes tekstin e dhënë për xhaminë e Haxhi Ismailit në Nikshiq. Shkruani të gjitha tiparet pozitive të objektit të caktuar kulturor dhe historik (monument), gjithçka që ky monument kontribuon në lidhjen midis njerëzve; si dhe gjithçka që ky objekt (monument) kontribuon në ndarjen e njerëzve, refuzimin e individëve, etj.). Nxirrni përfundimin dhe shpjegoni se si mund të ndikoni që qëndrimet e njerëzve në mjedisin tuaj të ndryshojnë në drejtim pozitiv.

Xhamia e Haxhi Ismailit

Dikur ekzistonin gjithsej katër xhamija në Nikshiq, poshtë qytetit, e Pashës, Haxhidanusha dhe e Haxhi Ismailit, të cilat u ndërtuan gjatë periudhës kur Nikshiqi ishte nën sundimin osman. Më e madhja dhe kryesorja nga këto të katërtat ishte Xhamia e Pashës, tek pusi Pashinac në qytetin e vjetër. E vetmja xhami që ekziston ende sot është Xhamia Haxhi Ismailit e vendosur në mahallën Gruda. Xhamia është me përmasa modeste, me një minare, një çati hips, një hajat përpara derës së përparme dhe një harem ose oborr të vogël xhamie.



▣ Xhamia e Haxhi Ismailit në Nikshiq (mahalla Gruda)

Xhamia gjithashtu kishte tarihun e saj (me mbishkrim të gdhendur në gur) dhe falë Petar Shobajiq, mbishkrimi nga tarihi është ruajtur, megjithëse ne sot nuk e kemi tarihin. Ky tarih tregon se xhamia u ndërtua në 1219 nga hixhrij dhe se vakifi i saj, ndërtuesi, ishte Haxhi Ismail Mehmednikiq Lekiq, nga fisi Gruda. Ai ishte një tregtar dhe falë biznesit të tij me Dubrovnikun dhe Sarajevën, ai fitoi një shumë të caktuar parash dhe, duke e konsideruar atë vepër për vullnetin e Zotit, filloi rindërtimin e urës në Dukël, e cila sot mban emrin e tij, dhe ndërtimin e xhamisë në mahallën e Grudës.

Nëse do të rillogaritnim vitin 1219 të hixhahut me vitet e epokës moderne, do rezultonte se viti i ndërtimit ishte 1804, megjithëse në shumë vepra historiografike thuhet se data e ndërtimit ishte 1807.

Pasi Nikshiqi u bë pjesë e Principatës së Malit të Zi në 1877, Xhamia e Haxhi-Ismailit u ruajt, e cila, me faktin se Bashkësia Islame në Mal të Zi u krijua në 1879, e para në Ballkan, është konfirmim i një jete harmonike të disa feve dhe konfesionëve. Xhamia në Nikshiq është rindërtuar disa herë me kujdes të veçantë për origjinalitetin e saj. Përveç besimtarëve islam, xhaminë e vizitojnë shpesh edhe besimtarët ortodoksë, veçanërisht gjatë Ramazanit dhe Kurban Bajramit, gjë që e bën atë simbol të bashkëjetesës në qytetin e nën Trebjesës.

Burimi: *Dnevne novine*, br. 2447, 10. i 11. avgusta 2019. (Hadži Ismailova džamija jedan od simbola suživota i gradu pod Trebjesom), 20-21; *Vijesti*, 26. januara 2020. god.; <https://m.cdm.me/drustvo/hadzi-ismailova-dzamija-jedan-od-simbola-suzivota-u-niksicu/>; <https://www.onogost.me/drustvo/niksic-kroz-istoriju-dzamije?page=4>


Grupi II:


Ura e Haxhi Ismailit në lumin Zeta në Dukël si një monument i trashëgimisë kulturore dhe historike të Boshnjakëve/Myslimanëve të Nikshiqit

Detyra: *Lexoni me kujdes tekstin e dhënë për urën e Haxhi Ismailit në lumin Zeta në Nikshiq. Bëni një intervistë imagjinare me Haxhi Ismailin në të cilën ai, nga këndvështrimi i tij, do theksojë gjithçka që ura kontribuon në lidhjen midis njerëzve. Nxirrni një përfundim ku nepërmjet intervistës me një person të rëndësishëm mund të ndikojë që qëndrimet e njerëzve në mjedisin tuaj të ndryshojnë në drejtim pozitiv.*

Ura e Haxhi Ismailit në lumin Zeta në Nikshiq

Sot, shumë qytete nëpër botë njihen nga urat e tyre. Falë etnologut Petar Shobajiq, studiues i të kaluarës së rajonit të Nikshiqit, dhe shënimit të tij të shkurtër për Haxhi Ismail Lekiq Mehmednikiq, e dhënë në librin “Nikšić-Onogošt” (Beograd, 1938), ky vakif i Nikshiqit u shkëput nga harresa përgjithmonë, ku përveç urës, la mënjanë pjesë të mirë të pronës së tij për xhaminë në mahallen e Grudës, e cila e ka gjatë krijuesit të saj.



 Ura e Haxhi Ismailit në lumin Zeta (Dukla)

Nga shënimi i Šobjaić, mësojmë se Haxhi Ismail ishte besimtar dhe kryente haxhin, si një nga pesë detyrat themelore fetare të myslimanëve. Ai i përkiste fisit të Grudës në Nikshiq dhe ishte tregtar, i cili në 1219 sipas Hixhretit (1804 sipas kalendarit Gregorian) la mënjanë një pjesë të parave të tij, duke i dhënë për ndërtimin e urës në vendin e quajtur Dukla.

Ura e Haxhi Ismailit, e vendosur në veri të qendrës së sotme të qytetit në distancë rreth 2 km, ishte 110 metra e gjatë (165 jardë), ku në fillim ishte zbukuruar me shtatë volt gjysmërrethor me gjashtë tumbulla (shtylla). Estetikisht, ndërtesa kishte një pamje jashtëzakonisht të bukur dhe, sipas rrethanave të atëhershme, një sipërfaqe të mjaftueshme të shkeljes, e cila ishte rreth 3.10 m. Ndërtuesi nuk mund ti dinte paraprakisht gjendjet e paparashikueshme në Zetë, kështu që, as nuk mund të supozonte se me rritjen e parë të nivelit të ujit, ura do përmytet. Në mënyrë që të vazhdojnë ta përdorin, ndërtuesit e rinj sakrifkuan elegancën për hir të funksionalitetit, kështu që u shtua një hapje tjetër, si dhe një superstrukturë, e cila çoi në ngritjen e nivelit dhe transformimin e tij nga të përkulur në të sheshtë. Gjatë “jetës” së saj, ura në Dukël mbijetoi rrethana të ndryshme, kështu që u rinovua me kalimin e kohës. Rindërtimi i gjerë i urës u bë gjatë vitit 2017, dhe për të tretën herë urës u “zgjat jeta”, e cila zgjat më shumë se tre shekuj.

Burimi: <https://www.novineniksica.me/iz-prolaznosti-u-vjecnost/>

Grupi III: Bedemi si monument i trashëgimisë kulturore dhe historike të Boshnjakëve/Myslimanëve të Nikshiqit

Detyra: Me kujdes lexoni tekstin e dhënë për Bedemin në Nikshiq. Shkruani të gjitha tiparet pozitive për objektin (monumentin) e dhënë kulturor dhe historik, gjithçka që ky monument kontribuon në lidhjen midis njerëzve; si dhe gjithçka që ky objekt (monument) kontribuon në ndarjen e njerëzve, refuzimin e individëve, etj. Nxirrni përfundimin dhe shpjegoni se si mund të ndikoni në qëndrimet e njerëzve në rrethin tuaj.

Bedemi në Nikshiq

Mbetjet e ruajtura të fortesës osmane Onogosht-Nikshiq gjenden në një kodër shkëmbore në pjesën juglindore të fushës së Nikshiqit. Ndërtimi i tij filloi në fund të shekullit XVII dhe përfundoi në vitet e para të shekullit XVIII. Qyteti ka dy njësi: në fushë - mbetjet të Qytetit të poshtëm me pesë kulla dhe sistemin e Qytetit të Epërm me gjashtë. I gjithë qyteti është i rrethuar me mure. Kalaja e njohur Onogosht është ndërtuar në kreshtën shkëmbore, të pjerrët që ngrihet mbi fushë 20-25 m. Ishte e gjatë 214 m, dhe në pjesën e mesme, ku është më e gjera, është rreth 30 m e gjerë.

Ana e murit perëndimor, pak më i gjatë i fortesës është 1,6 m i trashë, dhe ai lindor, mbi të cilin mbështetet pjesa e poshtme e qytetit është 1,1 m i trashë.

Në skajin jugor të fortesës, ngrihej një kullë trekatëshe pesëkëndëshe dhe në veri një kullë e ulët tetëkëndëshe.

Në mes është - Kastel, ndërtesa më e vjetër, e cila përbëhej nga dy topa, banesa e dizdarit dhe apartamenti i azapës (rojet e kalasë) dhe bodrumi i thellë, i ndërtuar mbi një qemer, i cili shërbente si depo për municion. Në pjesën më të lartë, kishte një platformë artilerie. Dy platformat më të vogla (tophane) ishin për një merzer dhe në pjesën jugore dhe lindore të kalasë mund të vendosnin individualisht 6-8 topa. Qyteti i poshtëm, i ndërtuar në formën e një katërkëndëshi, i mbrojtur nga fortësia, me të cilën bën tërësinë, dhe tre mure të larta 4 m, të trasha 1,45-1,5 m, me kulla në qoshe dhe në mes, ishte më e ngushtë, por dukshëm më e gjerë se e sipërmja. Muri lindor i qytetit të poshtëm, në cepat e të cilin ishte Prosenja dhe kulla e boshtit tetëkëndësh, me një pus dhe gur, dhe në mes Porta e Madhe, ishte 104 m



e gjatë, 66 m nga jugu dhe 86 m nga veriu. Kullat e transportit janë bërë për mbrojtjen e këmbësorëve. Kurora e mureve rreth qytetit të poshtëm ishte ndërtuar në formën e banketi, i cili kalonte nëpër kullë ku ushtarët mund të lëviznin nëpër të. Me kalimin e kohës, muret e qytetit u ngushtuan për të gjithë ata që kërkuan strehim në të, kështu që ndërtuan nën muret e qytetit dhe u shfaqen lagjet e para spontanisht - fillimet e qytetit të sotëm. Kjo është arsyeja pse zhvillimi i qytetit duhet të lidhet me fortesën e vjetër të qytetit, pavarësisht nga fakti se, shumë kohë para krijimit të tij, diku në fushën e Nikshiqit kishte një vendbanim romak Anderba, i cili u zhduk pa gjurmë dhe për vendndodhjen nuk ka burime të drejtperdrejta historike. Në këto bedeme dhe kulla të qytetit, vazhdimisht bëhej betejë jo vetëm për qytetin por edhe për epërsinë në kuptimin e gjerë. Bedemi sot është oaza e preferuar për të rinjtë dhe një vend ku organizohen ngjarje të shumta kulturore ...

Burimi: Petar Šobajić, *Nikšić-Onogošt*, Beograd 1938.

Grupi IV: Nishani në varrezat në Bisticë (guri i varreze) si monument i trashëgimisë kulturore dhe historike të Boshnjakëve/Myslimanëve të Nikshiqit.

Detyra: Lexoni me kujdes tekstin e dhënë për Nishanin në Bisticë. Bëni ndarjen që është e njëjtë dhe që është e ndryshme në dallim me gurët e varreve të popullsisë së besimit ortodoks. Nxirrni një përfundim që mund të ndikojë pozitivisht në qëndrimet të njerëzve në islam dhe ortodoks kur bëhet fjalë për gurët e varreve si tiparë të një kombi.

Gurët e varrezave ose monumentet, veçanërisht në zonat urbane, kanë një funksion kulturo-historik, monumental, estetik dhe peizazh. Guri i varrit tek popullsia myslimane në zonat tona quhen Nishan. Fjala nishan rrjedh nga gjuha persiane dhe përveç kuptimit të gurit të varrit, gjithashtu dmth qëllim, shënjestër, shenjë, gjurmë, pëlqim...Nishani, si gurë varresh, përfaqësonë një fenomen kulturor dhe artistik shumë interesant dhe të rëndësishëm edhe për Malin e Zi. Dikur në zonën e Nikshiqit dhe përreth ka pasur shumë varreza. Numri më i madh i banorëve të vdekur të fesë myslimane janë të varrosur në varrezat tek Bistrica, ku disa vjet më parë u ndërtua mejjithana me gusulhan. Ashtu si në varrezat e tjera dhe në varrezat afër Bisticës, vërehen pamje dhe forma të ndryshme në gurët e varreve. Në gurët e varreve nishan të ndërtimit të vjetër janë tre nishana përmbi, maja e të cilës përfundon në formën e turbanit. Dy nishana janë bërë prej betoni dhe në njërin prej tyre është e gdhendur sabra, dhe mund të kunkludojmë se dikush që mbante gradën e oficerit ishte varrosur aty. Sidoqoftë, një nga këto tre nishana tërheq vëmendje. Ky është nishani i vendosur në pjesën e poshtme të varrezave, në pjesën që është e sheshtë dhe e cila, së bashku me gurët e tjerë të varreve, deri vonë, ishte i ekspozuar tekave mashtruese të Bisticës. I gjithë nishani është i ndërtuar prej guri, për shkak të ndikimeve të natyrës është bërë gri. Në majë ka formën e fesit, e cila na tregon qartë se ajo u krijua pas vitit 1832, sepse, siç dihet, turbani si element dekorativ në gurët e varreve shfaqet pas atij viti. Ky simbol në një farë mënyre përfaqëson përkatesinë e borgjezisë së Perandorisë Osmane. Ekziston edhe një mbishkrim në arabisht në nishan që kuptojmë se Jakub Çanoviq ishte varrosur aty. Sot ky është nishan unik në Nikshiq me vlerën e tij estetike, artistike dhe epigrafike.

Burimi: <https://www.novineniksica.me/biljeg-proslosti-na-mapi-sadasnjosti/>



Grupi V: Porta dekorative e shtëpisë së Mekiqëve si monument i trashëgimisë kulturore dhe historike të Boshnjakëve/Myslimanëve të Nikshiqit

Detyra: Lexoni me kujdes tekstin e dhënë për shtëpinë e Mekiqëve dhe portën e saj. Imagjinoni që ju jeni në rolin e një punëtori turistik që duhet të hartojë një poster që do të nxjerrë në pah të gjitha tiparet pozitive për objektin e dhënë kulturor-historik (monument), gjithçka që ky monument kontribuon në lidhjen midis njerëzve; si dhe gjithçka që ky objekt (monument) kontribuon në ndarjen e njerëzve, refuzimin e individëve, etj.). Nxirrni një përfundim dhe shpjegoni se si mund të ndikoni në qëndrimet e njerëzve rreth jush.

Shtëpia e Mekiqëve në Nikshiq

Një nga shtëpitë më të vjetra në Nikshiq, e cila sot ndodhet në rrugën e Karagjorgjes nr. 6, dikur ishte pronë e familjes Mekiq.

Sipas burimeve historike, kur filloi ndërtimi i sheshit qendror të qytetit të ri në Nikshiq në 1884, kishte disa shtëpi të vjetra myslimane në atë zonë, të rrethuara me kopshte, rrugë, fushë...

Ato shtëpi, për të realizuar planin urbanistik të dr. Josip Slade, u shkatërruan, toka u rrafshua dhe u nda midis individëve për të ndërtuar shtëpi të reja.

Ndër të vjetrave ishin edhe dy shtëpitë e Mekiqëve. Njëra u shemb dhe tjetra, për të cilën është fjala në këtë tekst, mbeti dhe për një kohë të gjatë tërhoqi vëmendjen e kalimtarëve për dekorimin në portën e hyrjes. Pronarët e mëvonshëm murosën dritaret dhe instaluan të tjera shumë më të mëdha, duke ja ndryshuar pamjen shtëpisë, por ata nuk prekën portën e hyrjes.

Ndërkohë është kompletuar historia e pronarëve të saj të parë, familja e Fevzija Mekiq, nipi i Mushoviqëve të famshëm, i cili për një kohë të gjatë udhëheqi Nikshiqin. Në fakt, pas çlirimit të qytetit në 1877, vetëm 19 familje myslimane mbetën të jetojnë aty (v.1882), duke përfshirë Mujo Mekiqin nga Gruda. Gjatë luftërave Ballkanike, Mekiqët u shpërngulen në Turqi dhe morën mbiemrin Tara, sipas lumit Tara. Fevzi ia kaloi dashurinë për Nikshiqin djalit të tij Sharik Tara, biznesmen i lindur në Shkup në 1930, një nga evropianët më të pasur, pronari i sistemit ENKA.

Burimi: <https://www.novineniksica.me/najstarija-kuca-u-gradu/>



↗ Shtëpia e Mekiqëve



↗ Porta e shtëpisë së Mekiqëve

Vizatime nga jeta e përditshme e popullsisë myslimane Plevla (sh. XIX–fillimi i sh. XX)

MËSUESI	Mr Lilana Bajçetiq	Gjimnazi “Tanasije Pejatoviq”	
NJËSIA MËSIMORE	Përmbajtja e përkushtuar e studimit të historisë lokale		
UDHËZUES I ORËS	Dy orë të mësimi	III	
LËNDA MËSIMORE	Historia	KLASA	III vit i gjimanzit
TEMA E ORËS	VIZATIME NGA JETA E PËRDITSHME E POPULLSISË MYSLIMANE PLEVLA (sh. XIX–fillimi i sh. XX)		
QËLLIMET	<p>Edukative</p> <p>Nxënësit e kuptojnë gjërësinë dhe kuptimin e “leximit të re të historisë” ; përcaktojnë njohuritë e tyre për situatën në Ballkan, konkretisht në zonën e Plevlës, gjatë sundimit të Perandorisë Osmane, karakterizojnë situatën në Plevla në kushtet e pushtetit të dyfishtë; fitojnë njohuri për mënyrën dhe stilin e jetës urbane të popullsisë myslimane; kuptojnë rëndësinë e kontekstualizimit të jetës së përditshme; krahasojnë jetën e përditshme në të kaluarën dhe në të tashmen, lidhin njohuritë nga historia, sociologjia, letërsia dhe arti.</p> <p>Arsimore</p> <p>Me ndihmën e mësuesit nxënësit kërkojnë në mënyrë të pavarur, reflektojnë në mënyrë kritike mbi burimet historike dhe letrare, bazuar në njohuritë e fituara, "lexojnë midis rreshtave" dhe zbulojnë të kaluarën në një mënyrë të re; i shikojnë rrethanat historike nga këndvështrimi i një njeriut "të zakonshëm", konkludojnë se jeta e përditshme është "ajo që të gjithë e shohin dhe nuk e vërejnë" është një segment shumë i rëndësishëm i historisë dhe një burim i rëndësishëm për kërkime shkencore; kuptojnë ndikimin e trashëgimisë në të tashmen, të zbatojnë përmbajtjen e miratuar dhe përvojat metodologjike në jetën e tyre të përditshme.</p>		



QËLLIMET	<p>Operative</p> <p>Nxënësit njoftohen çështjet politike, ekonomike dhe kulturore ne Plevla në shekullin XIX dhe fillimin e shekullit XX në kohën e Perandorisë Osmane, kurse në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX me Perandorinë Austro-hungareze; njoftohen me elementet tradicionale dhe kulturore të perandorisë Osmane; njihen me mënyrën e jetesës qytetare së popullsisë myslimane; përvetësojnë njohuri për ndërlidhjen e jetës së përditshme dhe kontekstit shoqëror; shohin rëndësinë e njeriut "të zakonshëm, të vogël" në ngjarjet historike; njohin ngjashmëritë në mënyrën e jetesës së popullsisë së krishterë dhe myslimane, njohin ngjashmëritë dhe ndryshimet në lidhje me jetën moderne të përditshme dhe kontekstin e saj.</p>
REZULTATET E MËSIMIT	<p>Nxënësit deklarojnë karakteristikat e Perandorisë Osmane, dinë të shpjegojnë shkaqet dhe pasojat e administrimit të dyfishtë në Plevlë në fund të sh. XIX, fillimi i sh. XX, përshkruajnë situatën shoqërore në Plevlë, përshkruajnë pamjen e qytetit, nxjerrin në pah segmentet e rëndësishme të përditshme jetësore, karakterizojnë mënyrën e jetës së popullsisë myslimane, vërejnë ndryshimet, kontekstualizojnë jetën e përditshme, në mënyrë kritike "lexojnë" jetën e përditshme si burim historik; zbatojnë njohuritë e marra në situata konkrete, konkludojnë në mënyrë të pavarur lidhjen midis trashëgimisë dhe së tashmes.</p>
FORMA DHE METODA E PUNËS NË ORË	<p>monolog, dialog, tekstual, ilustrues-demonstrues. Frontale, grupore, individuale.</p>
Mjetet mësimore	<p>Hartë, tekste, fotografi, lëndë e përditshme</p>
LITERATURA	<p>D. Papović, S. Šabotić, A. Prekić, M.Šćekić, Istorija za treći razred gimnazije, Podgorica 2016,</p> <p>Grupa autora, Istorija Pljevalja, Pljevlja 2009.</p> <p>Geza Varadi, Imre Laki, Novopazarski sandžak-Pljevlja-1878-1908, Podgorica 2009.</p> <p>Marija Kocić, Orijentalizacija materijalne kulture na Balkanu, Beograd 2010.</p> <p>Ljiljana Bajčetić, Kultura svakodnevice Pljevalja tridesetih godina XX vijeka, Pljevlja 2018.</p> <p>Istorijska čitanka 1, Osmansko carstvo, Nastava moderne istorije jugoistočne Evrope, Podgorica 2012.</p> <p>Vehbija Bambur, Arhitektura stare pljevaljske kuće, Pljevaljske novine 15, januar 1966.</p> <p>Suraiya Faroqi, Sultanovi podanici, Kultura i svakodnevice u Osmanskom carstvu, Zagreb, 2009.</p> <p>Avdija Avdić, Političke prilike u Novopazarskom sandžaku krajem XIX i početkom XX veka</p>
Web link	<p>https://commons.wikimedia.org/w/index.php</p> <p>https://kesatnet.me/galerija-stara-pljevlja/</p> <p>https://www.youtube.com/watch?v=TxgxDNuFI74</p> <p>https://foruminfo.rs/kuca-jusufagica/</p>
Korrelacioni	<p>sociologjia, arti, letërsia, edukimi qytetar</p>

Përmbajtja (rrjedha) e punës



Përgatitja e nxënësit - hyrje në temë ose njësi

<p>RRJEDHA E ORËS:</p> <p>AKTIVITETI I HYRJES</p>	<p>- Në fillim, mësuesi njofton qëllimet e orës së mësimin, shkruan në tabelë emrin e njësisë mësimore dhe në të njëjtën kohë fillon prezantimin e PP me të njëjtin emër;</p> <p>- Mësuesi udhëzon nxënësit për termin "jeta e përditshme" dhe drejtshkrimin e saktë të këtij termi; i referohet teorive sociologjiko-antropologjike dhe historisë kulturore, kujton rregullat gjuhësore-gramatikore</p> <p>-Mësuesi jep udhëzime për ndjekjen e diapozitivës të prezantimit PP: secila përgjigje e saktë u jep nxënësve mundësinë që, në çifte, të zbulojnë fushat në njërin nga dy fotografitë, të cilat ndahen në katër segmente.</p> <p>Harta: Shtetet Ballkane 1878 në Kongresin e Berlinit Autori: http://upload.wikimedia.org/wikipedia/sr/d/d3/SanStefanoBalkan.jpg https://commons.wikimedia.org/w/index.php</p> <p>1. Xhamia e Husein-pashës (Historia e Plevlës) – bashkangjitja nr.2.</p> <p>2. Kampi i përqendrimit të ushtrisë Austro-Hungareze në Plevla (Varadi Geza, Imre Laki, Sanxhaku I Novopazarit – Plevla, fq.85) – bashkangjitja nr.3.</p> <p>- Mësuesi bën pyetje në lidhje me pushtimet osmane në Ballkan dhe zonës së Plevlës</p> <p>1. Kur vendet e Ballkanit ranë nën sundimin e Perandorisë Osmane?</p> <p>2. Shpjegoni situatën në Mal të Zi në fund të shekullit XV, fillimi i shekullit XVI?</p> <p>3. Si quhej vendbanimi që ndodhej në vendin e Plevlës së sotme?</p> <p>4. Kur ra Plevla nën sundimin osman?</p> <p>- Mësuesi bën pyetje në lidhje me vendimet e Kongresit të Berlinit në lidhje me Sanxhakun e Novi Pazarit dhe Plevlës?</p> <p>1.Kur është mbajtur Kongresi i Berlinit?</p> <p>Numëroni vendimet më të rëndësishme të Kongresit të Berlinit në lidhje me statusin e vendeve të Ballkanit.</p> <p>3. Cilat territore i fitoi Mali i Zi në Kongresin e Berlinit?</p> <p>4. Cilat vendime të Kongresit të Berlinit i referoheshin statusit të Sanxhakut të Novi Pazarit dhe Plevlës?</p> <p>Mësuesi shpjegon dhe interpreton temën e jetës së përditshme nga këndvështrimi i historisë kulturore.</p>
<p>AKTIVITETI KRYESOR</p>	<p>-Mësuesi citon G. Zimel ku thotë: "jeta e përditshme është ajo që të gjithë e shohin dhe nuk e vërejnë" dhe komenton mbi qëndrimet dhe mendimet e nxënësve</p> <p>-Mësuesi i lidh ngjarjet historike dhe jetën njerëzore në drejtim të përcaktuar të koordinatave të përmbajtjes së jetës së tyre. Në qendër vendos të ashtuquajturin njeriun e zakonshëm, një qytetar - një mysliman dhe një i krishterë ku jeta e tyre e përditshme ndryshoi ngadalë, në një histori që ndryshoi shpejt.</p> <p>- Mësuesi, nëpërmjet dialogut, veçon elementet e jetës së përditshme që do të analizojë si pjesë të jetës publike (pazarit) dhe jetës private (shtëpisë dhe kopshtit)</p>



**AKTIVITETI
PËRFUNDIMTAR**

të popullsisë së atëhershme myslimane në Plevla.

-Mësuesi shpjegon konceptin dhe origjinën e sheshit/pazarit në Plevla.

-Mësuesi i ndan nxënësit në tre grupe dhe jep udhëzimet për analizën e tekstit.

-Grupi i parë lexon tekstin nga libri: Suraiya Faroqi, besnikët e Sulltanit, Kultura dhe përditshmëria në Perandorinë Osmane, Zagreb, 2009.(bashkangjitja nr.4);

-Grupi i dytë lexon tekstin nga libri Marije Kociq, Orientalizimi i kulturës materiale në Ballkan (bashkangjitja nr.5);

-Grupi i tretë lexon tekstin nga libri Varadi Geza, Imre Laki, sanxhaku i Novopazarit-Plevla, Çarshija, 128-139, (bashkangjitja nr. 6);

-Mësuesi fillon një diskutim në të cilin nxënësit përshkruajnë dhe krahasojnë karakteristikat e jetës së popullsisë myslimane në qytetet osmane/Ballkan/Plevlë:

1.Në cilën mënyrë janë krijuar qytetet në Perandorinë Osmane?

2. Çka është çarshija/pazari?

3.Cilat janë karakteristikat e përbashkëta të qyteteve që u shfaqën në territorin e Perandorisë Osmane?

4. Shpjegoni rolin e pazarit në ekonomi dhe shoqëri osmane?

5. Shpjegoni rolin e esnafëve?

- Mësuesi tregon në diapozitivë rrugën kryesore të pazarit në Plevlë, rrugët dytësore (lagjet) dhe shtëpitë ku jetonte popullsia myslimane. Ai përshkruan dhe jep shpjegime, thekson se fotot tregojnë gjithashtu shtëpitë e popullsisë së krishterë; thekson ngjashmëritë në arkitekturë;

- Mësuesi tregon në diapozitivë karakteristikat e pamjes së jashtme të shtëpive dhe lexon tekstin (bashkangjitja nr.7);

- Mësuesi në diapozitivë tregon një qilim që ishte një pjesë e domosdoshme e brendshme në shtëpitë myslimane; përshkruan metodën e bërjes, thekson përdorimin e saj në shtëpitë e krishtërve (bashkangjitja nr.8);

Mësuesi në diapozitivë tregon brendësinë e një shtëpie myslimane (shpjegon ngjashmërinë me mënyrën e jetesës në qytetin fqinj) bën pyetje dhe u jep shpjegime nxënësve rreth emrave dhe qëllimit të disa mobiljeve (bashkangjitja nr.9);

Organizon një pyetësorë të shkurtër - shkruan në tabelë fjalë të panjohura që ka përdorur gjatë orës; kërkon përgjigje të sakta në lidhje me kuptimin e atyre fjalëve; i referohet njohurive të letërsisë – fjalë turke:

çarshija, mahala, sokak, kasaba, esnaf, oda, selamlik, haremluk, divanhana, furuna, doksat, hamam, avlija, sexhada, shiltet, minder, divan, mangal

-Pas përfundimit të kuizit, mësuesi shpall grupin fitues

- Mësuesi jep detyrat e shtëpisë - secili prej tre grupeve të formuar duhet:

a) sjell një recetë për të bërë një pjatë tradicionale që përgatitet në familjet myslimane

b) sipas mundësive, të përgatitet pjata dhe të shërbehen të tjerët.

<p>AKTIVITETET E NXËNËSIT</p>	<p>-Pjesa hyrëse e orës</p> <p>Nxënësit shkruajnë emrin e njësisë mësimore në fletore që përcaktohet për përmbajtjen e historisë lokale/Jeta e përditshme;</p> <ul style="list-style-type: none"> -Nxënësit ndjekin udhëzimet dhe ndahen në çifte për të punuar në orë; - Nxënësit dëgjojnë pyetjet dhe përgjigjen; - Pas përgjigjes së saktë, ata zbulojnë fushat në foto, në diapozitivë dhe përpiqen të njohin atë që tregohet në to; <p>-Ata zbulojnë fotografitë dhe japin shpjegime individualisht dhe me ndihmën e mësuesit.</p> <p>-Pjesa kryesore e orës</p> <p>Nxënësit ndjekin shpjegimet dhe i shkruajnë ato;</p> <ul style="list-style-type: none"> -Nxënësit shprehin mendimet e tyre mbi thënien e Zimel; paraqesin pikëpamjen kritike për rëndësinë e jetës së përditshme për studimin e historisë; -Nxënësit ndjekin prezantimin e mësuesit, komentojnë dhe japin mendimin personal mbi rëndësinë e segmenteve të caktuara të jetës së përditshme në kontekstin e ngjarjeve historike; - Nxënësit lexojnë tekstin dhe bëjnë shënime; - Nxënësit lexojnë tekstin dhe bëjnë shënime; - Nxënësit lexojnë tekstin dhe bëjnë shënime; -Nxënësit analizojnë tekstin, dallojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mënyrën e jetës së popullsisë myslimane në Perandorinë Osmane/në Ballkan/në Plevla; -Nxënësit shikojnë fotografitë, komentojnë, njohin pjesët të qytetit; -Nxënësit ndjekin prezantimin, komentojnë dhe shkruajnë; -Nxënësit përcaktojnë pjesët e qytetit dhe lokalizojnë vendet ku pjesët e arkitekturës tradicionale janë ruajtur deri më sot; -Nxënësit, duke përdorur njohuritë nga historia e artit, karakterizojnë pamjen e qilimave, shohin motivet e endjes, ngjyrën; komentojnë zejtarinë dhe talentin artistik të endësve, krahasojnë qilimat me llojet moderne të tapetëve, të shohë ndikimin e tradicionales në modelin modern; -Nxënësit shikojnë slajdin dhe u përgjigjen pyetjeve; paraqesin njohuri dhe përvoja personale. <p>-Pjesa e fundit e orës</p> <p>Nxënësit bien dakord në grup dhe japin përgjigje në lidhje me kuptimin e fjalëve të panjohura; ata shkruajnë në fletore kuptimet e tyre të sakta;</p> <p>-Nxënësit shkruajnë detyrat e shtëpisë.</p>
--------------------------------------	---



↓ Pamja e tabelës

VIZATIME NGA JETA E PËRDITSHME E POPULLSISË MYSLIMANE NË PLEVLA (sh. XIX - fillimi i sh. XX)

- Jeta e përditshme – “ajo që të gjithë e shohin por nuk e vërejnë”
- Sundimi osman në Ballkan dhe Plevla (sh. XIV - fillimi i sh. XX)
- Qeveria Austro-Hungareze në Plevla (v. 1878- v. 1908)
- Çarshija/pazari - një fytyrë e jetës së përditshme
- Shtëpia – sfera private e jetës së përditshme
- çarshija, mahala, sokak, kasaba, esnaf, oda, selamlik, haremluk, divanhana, furuna, doksat, hamam, avlija, sexhada, shiltet, minder, divan, mangal

<https://foruminfo.rs/kuca-jusufagica/>

↓ Bashkangjitjet

↓ Bashkangjitja nr.1:



↗ Harta: Shtetet Ballkanike 1878 në Kongresin e Berlinit <https://commons.wikimedia.org/w/index.ph>

▣ Bashkangjtitja nr.2:



↗ Xhamia e Husein - pashës - <https://kesatnet.me/galerija-stara-pljevlja/>

▣ Bashkangjtitja nr.3:



↖ Kampi i përqendrimit të ushtrisë Austro-Hungareze në Plevla, ↗
Varadi Geza, Imre Laki, Sanxhaku i Novopazarit – Plevla, fq.85



▣ Bashkangjita nr. 4:

Jeta në qytet: identiteti urban dhe mënyra e jetesës

Qytetet osmane ishin të ndara në lagje ku zakonisht jetonin midis pesë dhe njëqind familje, dhe nganjëherë më shumë. Ishte zakon që tridhjetë deri në dyzet familje të banonin në rrethin e qytetit. Në ato njësi mblihdeshin taksat e caktuara të cilat u përshkruheshin banorëve të tyre. Ata shpesh përfshinin njerëz të njëjtit religjion, grup etnik ose fesë .

Sidoqoftë, “autsajderat” kalonin shpesh në një rreth të qytetit, gjë që do ndryshonin pamjen e tyre me kalimin e kohës. Fqinjët shpesh ishin të lidhur me gjak. Banorët e rrethit të qytetit kontrollonin ata që hynin ose dilnin nga qyteti, kështu që kishte relativisht pak rrugë të gjera për të kaluar makinat. Në kohë të trazuara, banorët e disa lagjeve vendosnin hyrjen për t'u izoluar nga të tjerët. Zakonisht kishte edhe shumë rrugë pa krye që në një farë mase konsideroheshin rrugë publike.

Këto lagje ndaheshin qartë nga bota e jashtme, sepse mjeshtërit dhe tregtarët zakonisht nuk punonin aty ku banonin. Sidomos në qytetet më të mëdha, kishte shpesh “lagje biznesi” të përbërë nga bujtina, tregje të mbuluara dhe shpesh rrugë me dyqane të financuara nga fondacionet bamirësie. Pak njerëz vendbanonin në këto pjesë të qytetit.

Tregjet ishin faktorë të tjerë dhe vepruan kundër për tu izoluar në lagje.

Blerësit dhe shitësit e të dy gjinive takoheshin në tregje të hapura dhe nëpër dyqane.

Nevojat e përditshme mund të bliheshin jo vetëm në qendër të qytetit, por edhe në zona të banuara, megjithëse banorët zakonisht nuk ishin të entuziazmuar që kaq shumë dyqane dhe vende punësh po hapeshin në mjedisin e tyre. Gjithsesi, furrat dhe shitoret e ushqimeve që prishen duhet të ishin afër blerësve të tyre. E njëjta gjë ishte për banjot publike që disa i vizitonin rregullisht. Vetëm më të pasurit mund të kishin mundësi të ndërtonin në godinë një banjo të tyre. Gratë shkonin në dyqanet në qendër të qytetit në raste të veçanta dhe ata blinin shumë më shpesh në lagjen e tyre. Dihet për shumë ankesa të njerëzve të vrazhdë që ngacmonin kalimtarët. Nga akuzat u konkludua se gratë mund të ecnin rrugëve të lagjeve “të tyre” sidoqoftë kur të donin.

Sigurisht që shërbëtorët dhe fëmijët shpesh bënin punë të vogla jashtë shtëpisë. Në Stamboll, siç e përmendëm, kishte dyqane të preferuara të pëlhurave të qëndisura, të cilat pjesërisht i furnizonin gratë që punonin në shtëpi. Tregjet dhe dyqanet kështu kontribuan në integrimin e grave në shoqërinë urbane, megjithëse kjo shqetësoi shumë vëzhgues modernë.

Kishte edhe prodhues çantash që bënin punën e tyre në godina të lagjeve e, duke i furnizuar me sende ushqimore, veçanërisht me ujë. Lagjet e qytetit që ishin në kodra, si ajo rreth kalasë së Ankarasë, nuk kishin puse ose burime.

Disa prodhues padyshim përveç mallrave sillnin edhe lajme, dhe sa flisnin me amvise dhe shërbëtorë varej nga zakonet lokale dhe vetë njerëzit; në çdo rast, ekzistonte mundësia për at gjë.

Shitësit me pakicë në lagjet e banuara siguronin mallra nga fshatarët dhe kopshtarët nga zonat përreth, ose me shumicë nga shitësit në qendër të qytetit. Lajmet shpesh u përhapeshin përmes marrëdhënieve të tilla, veçanërisht ato në lidhje me thatësinë, rrugët e bllokuara tregtare, grurit të dobët dhe taksat e larta. Kështu, lidhjet midis banorëve të secilit vendbanim dhe tregtarëve lokalë, si dhe atyre midis tregtarëve dhe furnitorëve të tyre, kundërpeshuan situatën për t'u mbyllur që ishte një tipar i shumë lagjeve të qytetit.

Kështu, falë marrëdhënieve të përditshme tregtare, disa lagje të vogla banimi u bënë një qytet më i vogël ose më i madh.

Suraiya Faroqi, besnikët e Sulltanit, Kultura dhe përditshmëria në Perandorinë Osmane, Zagreb, 2009, 186-187

Bashkangjita nr. 5:

Veçori e çarshisë - fytyra të ndryshme të një jete të përditshme

Autori analizoi disa qytete në Ballkan që ishin nën sundimin osman: Beogradin, Shkupin, Prizrenin dhe Novi Pazarin dhe veçori karakteristikat e përbashkëta. Vendosja e qyteteve nga myslimanët filloi menjëherë pas pushtimit. Shteti bëri një përpjekje për të filluar aktivitete artizanale dhe tregtare në to. Zhvillimi urban i qyteteve të Ballkanit filloi me formimin e çarshisë/pazarit dhe mahalasë.

Disa rrethe të qytetit u bënë të famshëm për zejtarët që banonin në to. Ata ishin të ndërlidhur, por ato që kishin të bënin me fusha të tilla si ushqimi, tekstilet, armët, lëkura, druri, hekuri, ari, argjendi dhe bakri binin në sy. Dyqanet e zejtarëve gjendeshin në qendër të qytetit, në çarshi. Përjashtim në të gjitha qytetet ishin mahallat e duhanit që ndodheshin më shpesh në periferi, si rregull në vendet ku kishte ujë të rrjedhshëm. Era e pakëndshme që përhapet nga punëtoritë e duhanit përreth shkaktoi një bojkot të banorëve që nuk i donin ata në lagjen e tyre. Zejtarët u bashkuan me esnafët, anëtarët e të cilëve ishin të ndarë në mjeshtër, udhëtarët dhe çirakët. Disa kishin edhe skllëvër. Nga radhët e mjeshtërve, u zgjodh organi drejtues i esnafit, i ashtuquajtur Të Gjashtët, i cili u kujdes për respektimin e rregullave shtetërore dhe parandalimin e konkurrencës së padrejtë midis zejtarëve. Të krishterëve nuk është ndaluar të merren me zanate. Me ardhjen e osmanëve, u shfaqën zanate të veçanta që mbanin një karakter oriental. Njëri prej tyre ishte një kazanxhi që bënte sende prej metali, shpesh prej bakri. Sendet prej ari dhe argjendi fillimisht u bënë nga të krishterët, dhe më vonë myslimanët mësuan këtë teknikë të komplikuar të bërjes dhe morën përparësinë. Disa mjeshtër arritën përsosmërinë në mjeshtëri dhe shije artistike, kështu që disa prej tyre fituan karakterin e zanateve artistike që i përshtateshin punimet e tyre në aspekte të caktuara të jetës së përditshme, të cilat shërbenin për t'i kënaqur. Diapazoni më i madh u arrit në objektet e destinuar për klasën e elitës në pushtet.

Sidoqoftë, modeli i punës në përpunimin e argjendit dhe arit nga mjeshtër nga Lindja mbeti i paarritshëm për mjeshtër që punuan në çarshitë ballkanike. Zejtarët e krishterë u përpoqën të ruanin mënyrën e tyre të punës dhe të bërjes së teknikave, por me kalimin e kohës ata pranuan motive dhe ngjyra orientale (blu kobalt, jeshil, kafe). Ky ndryshim u soll nga çarshija si një vend ku kulturat e ndryshme takohen dhe përshkojnë. Nga shekulli XVIII ndikimet perëndimore depërtuan në kulturën osmane, pikërisht përmes Ballkanit. Në shekullin e XIX, elementi i krishterë në çarshi u bë më i fortë, kështu që kishte dallime në art, zanate dhe mënyrën e jetës. Ka pasur një rajonalizim të stileve, por ka pasur një rënie të cilësisë së mjeshtërisë.

Ishte e mundur të njiheshin dekorimet e bëra në Bosnjë ose p.sh. nga Maqedonia. Përveç zejtarëve, tregtarët kishin dyqane në pazar. Termi tuxhar ishte përdorur për ta. Bakali ishte një tregtar i specializuar në shitjen e sendeve ushqimore të destinuar për banorët e një lagjeje. Tregtarët ishin gjithashtu të bashkuar në esnafë. Me kalimin e kohës, u dalluan grupet që merreshin me tregtinë e mallrave të specializuara (bagëti, ushqim, tekstile dhe këpucë ...). Në vetë çarshinë, në përputhje me strukturën dhe biznesin e saj, kishte dyqane më të vogla, ndryshe nga tregtarët e specializuar.

Shtresëzimi në shoqëri u pasqyrua edhe në statusin e individëve në çarshi. Një nga shembujt më të mirë që ilustron këtë është tregtia e tekstit dhe veshjet lidhur me këtë tregti. Shtresat më të pasura të popullsisë myslimane përdornin brokadë, kadife të imët, saten, mëndafsh, në ngjyra të caktuara të lejuara vetëm për myslimanët si të kuqërremtë, jeshile, azure dhe vjollcë. Fillimisht, këto mallra vinin nga drejtime të ndryshme përmes tregtarëve në Dubrovnik, të cilët më vonë u shkarkuan nga tregtarët vendas. Numri dhe ndikimi i tregtarëve ishte vazhdimisht në rritje. Mundësia e fitimeve më të shpejta dhe më të larta, solli që nga shekulli i XVIII ndarjen e disa zejtarëve nga esnafi. Për shkak të rrethanave politike në fushën e tregtisë, kishte rajonalizim, kështu që çdo zonë më e madhe filloi të ndiqte politikën e saj të interesave ekonomike.

Marija Kociq, Orientalizimi i kulturës materiale në Ballkan, Beograd 2017, 171-177



▣ Bashkangjtitja nr.6:

Qyteti i Plevles - emri turk Taslixha

Pjesa më interesante e qytetit turk është çarshija, d.m.th. rruga kryesore. Jo një shesh panairi, jo një rrugë apo pazar, por një përzjerje e të treve. Vendi më tipik, më interesant në Plevla është çarshija. Bota e Lindjes. As çarshija e Sarajevës dhe as e Kostandinopojës nuk kanë një notë kaq lindore si ajo e Plevlës. Në rrugën e gjerë të pazarit - që duket më shumë si një shesh - ka rrugë dhe pasazhe të hapura majtas dhe djathtas, ngushtica nëpër të cilat do të ishte e vështirë të kalonin makinat. Në varësi të tregtarëve dhe zejtarëve që jetojnë në këto pasazhe ndryshojnë aroma, ngjyra, gjendja shpirtërore dhe karakteristikat. Sipas sistemit të vjetër të esnafëve, mjeshtrat e të njëjtit profesion do të ishin të vendosur njëri pas tjetrit. Nuk flitet për një frymë konkurruese. Relaksimi dhe rehatia lindore nuk lejojnë diçka të tillë. Çmimi i mallrave do të varet nga fati dhe përvoja. Gjithçka është mirë atje ku ka qenë dhe ku është, jo siç mund të ishte. Në atë kohë, konceptet e tregtisë dhe ekonomisë nuk ndryshonin. Prodhuesit i shesin mallrat vetë. Tregtarët e vetëpunësuar janë më pak të zakonshëm.

Le të hyjmë në kalimin e parë. Prodhuesit e thikave jetonin atje. Duhet ta dish punën. Përveç thikave të mira shtëpiake, turke, shpesh shihen edhe marka frënge, angleze dhe shenji i solingenit (thikë gjermane) në dorëzën e thikes, motive boshnjake të zbkuruara në dorezë. Në atë aspekt, prodhuesit e thikave në Plevla tejkaluan prodhuesin e mirë, të vjetër, tashme të vdekur nga Segedini. Rruga tjetër do të pushtohet nga kazanxhi. Këtu ishte ende një zanat i çmuar.

Mohamedanët dhe të krishterët do të përdornin enë bakri për të përgatitur dhe shërbyer ushqim. Ata i kushtuan shumë vëmendje pamjes artistike të këtyre enëve. Familjet e pasura, me shërbëtorë të shumtë, do të investonin të gjithë pasurinë e tyre në enë bakri. Mikpritësit fisnikë e kshin poshtë nderit përdorimit e enëve prej dheut që perdoreshin nga të varfërit. Tregtia e argjendarisë, në ndërthurje me profesionin e kazanxhisë, ngrihet në nivelin e artit. Gjurmët e zejtarisë së argjendarisë mund të shihen në enët prej bakri të familjeve më të pasura. Pompoze janë tabaket e mëdha në të cilat u shërbente ushqimi. Kazanxhitë gjithashtu bëjnë pajisje për pjekje - mulli kafeje. Rruga tjetër tashmë ka një erë më të këndshme. Punëtoritë e këpucarëve dhe prodhuesve të këpucëve gjenden atje. Ata zotëruan aftësinë artistike për ti bërë deri në detajet e fundit. Interesante janë çizmet e gjera të kuqe ose të verdha pa thembra të lidhura, që vishen ekskluzivisht nga turqit kur largohen nga haremi.

Ata hyjnë në to me këpucë ose pantofla dhe i tërheqin këmbët me hapa të vështirë ndërsa ecin nëpër rrugë. Për shkak të ecjes së tyre specifike, ata do të njiheshin edhe nëse kishin veshur një mantel të stilit evropian. Bërja e çizmeve kërkon lëkurë të bërë nga lëkurëpunuesit. Dhe në Plevla, lëkurëpunuesit janë në rrugën në fillim të së cilës ju tashmë mund të ndjeni erën e njohur. Ekziston një përrua në rrugën e fabrikës së lëkurës, kështu që mund të themi se ky vend u krijua për përpunimin e lëkurës. Në bregun e përroit ata pajisin dyqanet e tyre, fabrikat e lëkurës dhe lëkurat e thata, dhe i shesin. Në rrugën tjetër janë tregtarët që shesin mallra me masë të shkurtër. Nga kjo lagje hyjmë në pjesën më të lumtur, më të gjallë të çarshisë ku kishte disa dyqane ëmbëlsirash. Ata shisnin kumbulla në mjaltë, alva dhe pite me mjaltë. Pite freskët e bërë me mjaltë do të ishte e shijshëm, por e ftohur nuk është më për stomakun evropian...Ëmbëltorët kalojnë më së miri gjatë festave të gjata të Ramazanit dhe Bajramit.

Si në çdo qytet të madh dhe në Plevla, afër vendit për festa, ka dyqane me mallra luksoze. Midis ëmbëltoreve, pjektorëve dhe kafeneve, u ndërtuan dyqanet e kazanxhive. Prodhimi i bizhuterisë turke është një zanat veçanërisht interesant. Arti i tyre është i lidhur me marangozët dhe është menduar më shumë për syrin sesa për nevojat e përgjithshme. Kishte disa argjendar në Plevla. Midis mjeshtrave, shquhej mjeshtri Tadija, i cili ishte një artist i dhënë nga Zoti. Përsosmëria e tij në prodhim erdhi nga paraardhësit e tij, gjithashtu argjendarët dhe Venedikasit nga të cilët mësoi zanatin. Në

rrugën tjetër ishin farkëtarët, më pas tapicierët, armëpunuesit, tregtarë të shumtë të pijeve alkoolike dhe verërave. Ka shumë klientë. Më i shquari midis tregtarëve të verës është tregtari Zhivkoviç. Çarshija ishte më piktoreske dhe origjinale të hënën, gjatë tregut të javës. Hapësira do të mbushej me tollovi dhe zhurmë shurdhuese. Herë pas here do të kishte një turmë pa ndonjë arsye. Blerësit u qortuan dhe shitësit i lavdëruan mallrat.

Varadi Geza, Imre Iaki, Sanxhaku i Novo Pazarit - Plevla, Podgoricë 2009, 128-139

▣ Bashkangjtitja nr.7:

Shtëpia - zona e privatësisë

Duke pasur parasysh praninë e kahershme të qeverisë Osmane, ndikimi i ndërtimit oriental ishte më i theksuar në arkitekturën e shtëpive. Ndërtuesit vendas e pranuan atë dhe e përshtatën sipas mundësive dhe nevojave. Ata gjithashtu prezantuan elemente të arkitekturës shtëpiake, profane dhe rurale. Kjo u pasqyrua veçanërisht në mënyrën e ndërtimit të mureve me gurë të grimcuar, në ndërtimin e barierave prej druri nga trarët, të ashtuquajturat gable dhe strukturat e kulmit. Stili i tyre i ndërtimit ka pasur ndikim nga mjeshtrat e ardhur nga jashtë, kryesisht nga Dubrovniku.¹ Ndërthurja e ndikimeve të ndryshme, të paktën në fragmente, i dha disa karakteristika specifike arkitekturës së ndërtesave të qytetit, publike dhe private. “Në arkitekturën e qytetit, nuk kishte dallime të rëndësishme në ndërtim midis shtëpive myslimane dhe të krishtera. Karakteristika kryesore e kësaj arkitekture është horizontali i theksuar, veçanërisht në rreshtat e dritareve në katin e parë, mbi të cilin janë shumë të theksuara qepallat e thella të çatisë me një pjerrësi të lehtë, gjë që kushtëzohej nga faktorë klimatikë. Vertikalet janë të shënuara vetëm në cepa, shtylla dhe oxhakë të hollë...Ato janë pikturuar me ngjyra jashtëzakonisht të ndritshme.² Dallimet në planin e dhomave në shtëpi ekzistonin, por kishte ndryshime edhe në këtë segment. Tani është e rrallë të gesh një shtëpi myslimane të pasur që ka mbajtur planin e saj të vjetër të ndërtesave: selamlukun (pavijone ku u pritëshin dhe ku rrinin burrat), dhe haremlukun (pavijone ku ishin vendosur gratë), siç mund të shihej më parë, as ato mure të larta midis tyre. Gjithçka është ridizenjuar dhe rindërtuar sipas nevojave reale”.³

Shtëpitë, pothuajse si rregull, kishin një kat përdhes dhe një kat të parë. Në katin e parë kishte një kuzhinë dhe një depo ose qilar. Nuk ishte e pazakontë që të kishte pjesë banimi në katin e parë, në dimër, sepse ishte ndërtuar me dysheme më të trasha, ndërsa kati i parë ishte me mure më të holla dhe më të lehta. Dyshemeja kishte një konstruksion druri me mbushje muresh prej druri ose qerpiçi. Në të “arrihej me shkallë të jashtme të pjerrëta dhe të mbuluara”.⁴ Në verë, njerëzit jetonin në dhoma, por shumicën e kohës ata jetonin jashtë, në divane dhe në kopshte.⁵ Organizimi i brendshëm dhe mobiljet ishin strukturuar sipas modeleve muslimane dhe evropiane. Brendësia e shtëpive varet gjithashtu nga pozicioni material i familjes. Kishte pak orendi në shtëpitë e varfra dhe ato ishin modeste, mbi të gjitha të përshtatura për funksionimin dhe për dhomat të vogla. Në shtëpitë më të pasura, mobiljet ishin më moderne, të blera në qytete të mëdha ose të porositura nga marangozët

1 Nijazija Koštović, Pljevlja – Šeher kasaba, Taslidža, Sarajevo 2003, 22

2 Vehbija Bambur, Arhitektura stare pljevaljske kuće, Pljevaljske novine, 15. januar 1966, 8

3 Obrad Leovac, Po Sandžaku – Pljevlja, u: Dobrilo Aranitović, Zavičajni zapisi Obrada Leovca, Breznički zapisi, br.13 – 14, Pljevlja 2000 – 2001, 148

4 Vehbija Bambur, Arhitektura stare pljevaljske kuće, Pljevaljske novine, 15. januar 1966, 8

5 Značenje riječi divanhana – balkon, doksat, potiče od riječi divan- tur.divan, turski državni savjet, popis poreskih obveznika, istočnjačka sofa s jastucima, Milan Vujaklija, Leksikon Stranih reči i izraza, Beograd 1980, 214



vendas. “Në to përdorej gdhendja në dru, veçanërisht në tavanet dhe dyert për mysafirët.”⁶ Ishte i njohur Arso T. Popoviqi, i cili e mësoi zanatin në Sarajevë nga një mjeshtër gjerman, me të cilin gjithashtu punoi në Vjenë.

Punimet e tij: dollapët, tavolinat, karriget, dollapët kishin vlerë artistike. Një marangoz i shkëlqyeshëm ishte Hanefija Cokoviq, e njohur gjithashtu për prodhimin e këpucëve prej druri, të cilat visheshin kryesisht nga gratë myslimane, por edhe krishtere.⁷

Nevoja për t'i bërë kushtet e jetesës më të këndshme dhe moderne solli një ndryshim të rëndësishëm në rregullimin e hapësirës së jetesës: “Asnjë nga elementët dekorativë të përdorur në shtëpi nuk lindi vetëm nga dëshira për të dekoruar, por të gjithë, fillimisht, kishin vetëm qëllim konstruktiv ose funksional.⁸ Muret dhe zdrukthtaria në shtëpi janë pikturuar në mënyra të ndryshme. Tavanet pikturoheshin edhe në shtëpi të pasura. Kjo punë është bërë nga piktorë mjeshtër. Përveç vendasve, me ftesë vinin edhe mjeshtra nga jashtë.⁹

Në shtëpi më të pasura, kishte një dhomë që shërbente si banjo. Në të kishte një sobë për të ngrohur ujin e banjës. Uji derdhet në një enë bakri me një rubinet që varej nga tavani, kështu që dukej si dushi i sotëm. Ulëshin në sediljet e rreshtuara poshtë dritares, të kufizuara nga jastëkët e stolitur. Dyshemetë ishin të mbuluara me rreshterë dhe qilima. Dhomat ngroheshin nga brazije me qymyr druri. Shpesh ishte e gdhendur dhe shërbente si zbukurim. Në shtëpitë krishtere, dhomat ngroheshin me furra bronzi. Tavani ishte prej druri dhe i zbukuruar, me gdhendje pak a shumë të pasura. Në mes të dhomës ishte një tavolinë me karrige. Veshjet u mbajtëshin në arka dhe dollapë, zakonisht të gdhendura bukur. Zakonisht u rreshtoshin mollat ose ftojtë mbi to, që një erë e këndshme të përhapet në dhomë.¹⁰

Numri i dhomave në shtëpi varej nga pozicioni socio-ekonomik i familjes. Familjet më të varfra kishin dy ose tre dhoma “universale”: një dhomë në të cilën kryheshin aktivitetet e përditshme dhe një dhomë në të cilën flinin. Shtresat më të pasura kishin shtëpi me më shumë dhoma. Ata ishin në gjendje të ndajnë hapësirën në të cilën punojnë nga ajo në të cilën jetojnë. “Vetë shtëpia familjare kishte katër dhoma dhe ishte e veçantë. “Dhoma më e vogël” mbeti në kujtesë. Në të, gjyshja ishte ulur në një dyshek, pranë një sobë të vogël brazier - furrë, duke i bërë vetes kafe dhe duke e pirë atë. Gjithçka që i duhej ishte rreth asaj furre... për të bërë shumë punë, pak lëvizje ishte e nevojshme. Ajo i bëri të gjitha në mënyrë paqësore dhe pa shkatërruar jetën e saj”. Shtëpitë më të mira në këmbë kishin një “dhomë vizite” për mysafirët. Ishte e mbuluar me qilima dhe shtrati ishte “modern në atë kohë, i bërë prej hekuri, i lyer me të gjelbër, me doreza bronzi. Muri mbi të ishte i mbuluar rreshter, ndërsa muret tjera me ikona dhe fotografi familjare.¹¹ Qilimat ishin punë dore dhe ruajtën me shekuj. Ato ishin bërë në zbukurime bimore dhe gjeometrike: “Sipas mendimit tim, vetëm në Plevla ishin prodhuar qilima dhe rreshterë me një lule të madhe të stilizuar nga tulipanët, trëndafilat dhe të ngjashmet me kufirin përreth me tendinat e bimëve.”¹²

Dhomat e përbashkëta në shtëpitë e pasura ishin pjesa më e rëndësishme e shtëpisë, sepse në to u mbledheshin anëtarët e familjes dhe mysafirët. Ishte dhoma më e madhe dhe, meqenëse kishte një funksion publik, ishte edhe më e pajisura. Ajo ekspozoi vlerat e statusit të familjes, pjata të shtrenjta,

6 Vehbija Bambur, Arhitektura stare pljevaljske kuće, Pljevaljske novine, 15. januar 1966, 8

7 Istorija Pljevalja, Pljevalja 2009, 561

8 Vehbija Bambur, Arhitektura stare pljevaljske kuće, Pljevaljske novine, 15. januar 1966, 8

9 Ahmed Tahirbegović, Pljevlja i pljevaljska čaršija, Sarajevo 2009,58

10 Nijazija Koštović, Pljevlja – Šeher kasaba Taslidža, Sarajevo 2003, 35

11 Isto,

12 Nijazija Koštović, Pljevlja – Šeher kasaba, Taslidža, Sarajevo 2003, 29



ikona, shandanë, fotografi. Kuzhina, ku zhvillohej pjesa më e madhe e jetës familjare, gjithashtu luajti një rol të rëndësishëm. Shtëpitë e pasura kishin një shërbim që siguronte dhe përgatiste ushqim. Një tipar i rëndësishëm i brendshëm ishte lidhja e saj me mjedisin. Të gjitha shtëpitë, të krishtera dhe myslimane, kishin kopshte, oborre që ishin të rrethuara. Shtëpitë, afër rrugës kryesore, kishin më pak hapësirë për oborrin, sepse ndërtimi ishte më intensiv në atë zonë. Kopshtet dhe oborret në Moqevac dhe Shevari shquheshin për bukurinë e tyre. Shtëpitë myslimane nuk kishin dritare në anë të shtëpisë nga rruga në katin përdhësë.¹³

Shtëpia ishte e hapur në oborr, dhe anët u quheshin “mashkull” dhe “femër”. Mashkulli ishte në hyrje si “i pari” dhe femra si “e dyta”, prapa shtëpisë, në mënyrë që të parandalonte kontaktin e drejtpërdrejtë të grave, anëtarëve të familjes, me vizitorët. Edhe midis të krishterëve, hapësira përreth shtëpisë ishte e ndarë. I ashtuquajtur i oborri i parë, ishte në hyrje në rrugë dhe ishte i shtruar me kalldrëm. Në të kishte një hapësirë ku rriteshin lule, shkurre, dekorime, të cilat përfaqësonin shtëpinë për vëzhguesin. Në oborrin “e dytë” kishte një shtëpi dhe hapësirë ndihmëse, një kuzhinë/ mutvak/, një hambar. Këto hapësira ndihmëse ishin të vendosura në një farë distance nga shtëpia, mundësisht të fshehura nga sytë e vizitorëve, si hapësira “të papastra” që degradonin disi oborrin e shtëpisë. Familjet e qytetit shpesh mbanin bagëti, të cilat ua jepnin barinjve për tu ruajtur. Në oborrin e “tretë”, prapa shtëpisë, zakonisht kishte një pemishte dhe një kopsht lulesh. Shtretërit e perimeve dhe frutave, pemëve dhe luleve, pasuruan hapësirën e oborrit. Ishte një hapësirë për aktivitete të caktuara, një vend ku dikush mund të ishte vetëm. Ishte një hapësirë sensuale, mbi të gjitha “aromatike”, sidomos në verë. Ishte gjithashtu një hapësirë vizuale “dekoruese” e cila e bënte shtëpinë dhe banorët më të vlefshëm.¹⁴ Megjithëse të rrethuara, oborret ishin afër, kështu që ato ishin një vend për vendosjen dhe mirëmbajtjen e lidhjeve fqinjësore. Dikush mund të “bisedojë”, të negociojë, të fliste thashetheme. Këto ishin gjithashtu zona “akustike” nga të cilat mund të dëgjohej “e qeshura, e qara dhe më shpesh një këngë, e trishtuar, e dashur”.

Edhe pse hapësira e privatësisë, oborri, ishte një instrument komunikimi. Fqinjët dhe vizitorët përfshinin familjen në jetën reale, të përditshme, duke e bërë atë një vend takimi privat dhe publik. Ishte gjithashtu një hapësirë ku njeriu, që jetonte në qytet, ndjehej pjesë e natyrës dhe fshatit, gjë që ishte një tjetër karakteristikë e tij ambivalente. Kultivimi i perimeve dhe frutave i dha kësaj zone një funksion ekonomik, por ishte në prapavijë. Më shumë vëmendje i ishte kushtuar luleve, përkatësisht qëllimit të saj dekorativ: “Kulti i luleve ishte rritur në oborre, ata mbanin erë jargavan, trëndafila, karafila, kadife, bejturan dhe së bashku me zhurmën e burimeve i jepnin një ndjesi të veçantë çdo njeri. Kopshtet ishin plot me kumbulla të shëndetshme, arra, dardha të mira, mollë, qershi dhe të gjitha llojet e perimeve.¹⁵ Këto pjesë të “shtëpisë” kishin një dimension tjetër - ato shiheshin si një hapësirë për gratë, një vend ku takohen vajzat dhe gratë, ku punonin dhe kalonin kohë. si pjesë e kohës së lirë për argëtim. Për te lidhen kujtimet sentimentale për dashurinë dhe romancën.

Lilana Bajçetiç, Kultura e jetës së përditshme në Plevla në vitet e tridhjeta të shekullit XX, Plevla 2018, 161-166

13 Nijazija Koštović, Pljevlja, Šeher – kasaba, Taslidža, Sarajevo 2003, 35

14 Isto, 17 – 19

15 Uzeir Bećović, Pljevlja, tragom vremena, Pljevlja 1992, 32



▣ Bashkangjtitja nr.8:





<https://kesatnet.me/galerija-stara-pljevlja/>



<https://foruminfo.rs/kuca-jusufagica/>

Rishikimi i realizimit të orës:



Marko Radojeviq

Afirmimi i bashkëjetesës dhe tolerancës - Burrëria

Lënda shkollore: Historia	
Klasa: III IV	Mësimdhënësi: Marko Radojeviq

Tipi i orës:	Përpunimi i përmbajtjes së re, prezantimi i asaj që është mësuar
Tema mësimore:	Mali i Zi në Luftën e Parë Ballkanike Mali i Zi në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve
Qëllimi i orës:	Nxënësit duhet të: Mësojnë rreth teknikave të koordinimit, organizimit dhe prezantimit; Zhvillojnë ndjeshmërinë, kulturën e solidaritetit dhe mirëkuptimit, si dhe kulturën e bashkëjetesës.
Rezultatet e mësimit:	Të analizojnë dhe vlerësojnë në mënyrë kritike pozicionin e popujve pakicë në Malin e Zi; Të analizojnë materialet mësimore dhe burimet historike dhe nxjerrin përfundimet e tyre; Të krahasojnë pozicionin e popujve pakicë në shtetet e sapo krijuara; Te përshkruajnë shembuj individualë të një kulture të bashkëjetesës dhe analizojnë ato në kontekstin e periudhës historike në të cilën ato ndodhin; Të vlerësojnë pozitivisht shembuj konkretë dhe kontributin e tyre në zhvillimin e bashkëjetesës në komunitet.
Format e punës:	Punë frontale, individuale dhe grupore, punë në tekstin mësimorë.
Metodat e mësimdhënies:	Punë monologjike, dialoguese, ekipore, dëftore.
Korelacioni:	Sociologjia, informatika
Mjetet mësimore:	Fletore, projektor, tabelë për projektor, lidhje interneti.
Koha e nevojshme për realizim:	Një orë shkollore (45 minuta)

Shënim: Për realizimin e këtyre qëllimeve dhe detyrave është e nevojshme përgatitja e nxënësve (hulumtimi i temës, bashkëpunimi me anëtarët e ekipit, vendosja e bashkëpunimit me komunitetin lokal: Arkivi i shtetit Berane, Biblioteka popullore Radovan Lllaliq – Berane, radio emituesi lokal – Portal Radio Berane);

Literatura:

Libri për klasën e III-të të Gjimnazit/Udžbenik za III razred Gimnazije;
Libri për klasën e IV-të të Gjimnazit/Udžbenik za IV razred Gimnazije;
Rastoder Šerbo, “Kad su vakat kaljali insani: Šahovići 1924,” Alamanah, 2011;
Biblioteka Istorijskog instituta Univerziteta Crne Gore, Podgorica, K85/Istočni odred crnogorske vojske 1912, br.358, 06.10.1912. Oblasni upravitelj iz Kolašina kom. J.Plamenac piše Serdaru Janku Vukotiću;

Web linqet: <https://magazinplus.eu/srdan-aleksic-umro-je-vrseci-svoju-ljudsku-duznost/>

Materiali i mbledhur do të jetë në dispozicion të publikut përmes internet poratalit të Radio Berane në formën e blogut studentorë, si dhe përmes profileve në rrjetet sociale.

Rrjedha e orës::

Aktiviteti hyrës: Bazuar në përgjigjet e pyetjeve të bëra, nxënësit njihen me temën (Bashkangjittja nr. 1), dhe më pas ndahen në tri (3) grupe për tu njohur me temën.

Aktiviteti kryesor: Ata marrin material për punë nga mësuesit dhe, duke ndjekur udhëzimet për punën e tyre specifike, lexojnë dhe analizojnë materialin mësimor. (Bashkangjittja nr. 2);

Grupi I merr materialin mesimorë “Kad su vakat kaljali insani: Šahovići 1924,”Kume, danas ti nijesam dobrodošao. (Bashkangjittja nr. 3);

Grupi II merr burimin historik nga Biblioteka Istorijskog instituta Univerziteta Crne Gore, Podgorica, K85/Istočni odred crnogorske vojske 1912, br.358, 06.10.1912. Oblasni upravitelj iz Kolašina kom. J.Plamenac piše Serdaru Janku Vukotiću.. (Bashkangjittja nr. 4);

Grupi III merr materialin mësimor nga libri “ Kur kohën e kan njollosur të çmendurit: Shahoviqi 1924,” Mijajlo Vladimirov Ashanin: Sakrifikimi për të tjerët, se si Novak Ashanin shpëtoi Mustafen Musliq, një fëmijë 12 - vjeçar (bashkangjittja nr. 5) dhe materialin nga linku : <https://magazinplus.eu/srdan-aleksic-umro-je-vrseci-svoju-ljudsku-duznost/> (Bashkangjittja nr. 6).

Aktiviteti përfundimtar: Nxënësit vlerësojnë së bashku kulturën e bashkëjetesës, ndihmës reciproke dhe ruajtjes në territorin e Malit të Zi, si një nga elementet e trashëgimisë kulturore jomateriale të Malit të Zi.

Aktivitetet e nxënësit:

-Nxënësit përshkruajnë pikëpamjen e tyre për termin burrimi dhe u përgjigjen pyetjeve të bëra (Bashkangjittja nr. 1);

-Nxënësit ndajnë njohuritë e tyre të mëparshme për shembuj të ngjashëm;

-Përshkruajnë shembuj individualë nga kultura e bashkëjetesës;

-Ata i analizojnë ato në kontekstin e periudhës historike në të cilën ato zhvillohen;

-Analizojnë ngjashmëritë dhe nxjerrin një përfundim në lidhje me pozicionin e popujve pakicë;

-Ato ndahen në grupe dhe bazuar në udhëzimet i qasen zhvillimit të detyrës;

-Diskutojnë, shpjegojnë dhe përshkruajnë pikëpamjet e tyre, rishikojnë në mënyrë kritike pozicionin e popujve pakicë në Malin e Zi;

-Përmes zhvillimit të detyrave të shtëpisë, i qasen punës hulumtuese, dmth. vendosin bashkëpunim me përfaqësuesit e komunitetit lokal dhe përipiqen të gjejnë në burimet historike, traditën gojore





dhe veprat letrare shembuj të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe bashkëjetesës në zonën e Beranes dhe përmes krijimit të një blogu studentorë ata publikojnë shembuj pozitiv të bashkëjetesës.

↘ **Bashkangjitja nr. 1:**

Cili është përkufizimi i termit burrëri?

Cili autor e përkufizoj këtë term në vendin tonë?

A dini sipas përkufizimit ndonjë shembull nga e kaluara e afërt?

-Burrëri është të mbrosh të tjerët nga vetja

-Marko Miljanov

A dini sipas përkufizimit ndonjë shembull nga e kaluara e afërt?

A keni dëgjuar për vendin Shahoviq?

A dini ndonjë shembull nga Mali i Zi që i përshtatet këtij koncepti?

A mund të përkufizohet termi burrëri si një pasuri kulturore jomateriale e Malit të Zi dhe pse?

↘ **Bashkangjitja nr. 2:**

Detyra per grupin I: Bazuar në materialin mësimor, nxënësve u jepet detyra të analizojnë një shembull nga materiali, dmth. një akt shpëtimi.

-Analizoni vendimin e individit (Jakobit) në kontekstin e devijimit nga grupi, dmth. vendimet e grupeve

- A mund ta imagjinoni veten në një situatë kur ju kundërshtoni shumicën dhe vendimin e shumicës për të ndihmuar më të dobëtin, nëse ky vendim mbart rrezik për ju?

Detyra per grupin II: Bazuar në burimin historik, nxënësit përpiqen të rindërtojnë atmosferën në Berane në tetor 1912, para se ushtria malazeze të hynte në qytet.

-Si është atmosfera në qytet?

-Pse ndjen frikë dhe pasiguri?

-A shfaqet solidariteti në një situatë të pasigurisë së madhe?

-A a dallohet në këtë burim shembulli i solidaritetit?

Detyra për grupin III: Bazuar në materialet mësimore, nxënësve u jepet detyra të krahasojnë dy ngjarje nga dy periudha të ndryshme dhe t'i analizojnë ato:

-në kontekstin e mjedisit

-të analizojë rëndësinë e aktit në kontekstin e kohës në të cilën merren vendimet (marrëdhënie të tensionuara, intolerancë, mosbesim i ndërsjellë)

Detyra shtëpie: Të ndarë në grupe, nxënësit duhet të vizitojnë Arkivin e Shtetit - Berane, Bibliotekën Popullore Radovan Llalliq - Berane dhe të gjejnë në to materialin që dëshmon për shembuj të bashkëpunimit dhe mbrojtjes së ndërsjellë midis popullatës myslimane dhe ortodokse në Berane gjatë Luftës së Parë Ballkanike, si dhe menjëherë para dhe pas përfundimit të së njëjtës. Këta shembuj duhet të formulohen në formë të shtypur dhe elektronike dhe prej tyre të formojnë një libër të klasës "burrëria". Në klasën tjetër, të prezantohen, të diskutohet rreth tyre, të vihen re ngjashmëritë dhe ndryshimet dhe përmes diskutimit të arrihet qëllimi i klasës: **Të zhvillojnë ndjeshmërinë, një kulturë solidariteti dhe mirëkuptimi, si dhe një kulturë për të jetuar së bashku.**

Këta shembuj do të paraqiten për publikun e gjerë pas klasës përmes një blogu që do të krijohet në bashkëpunim me Portalin Radio Berane, si dhe në llogaritë e rrjeteve sociale që do të krijohen nga nxënësit.



▣ **Bashkangjitja nr. 3: (grupi I):**

Kumbara im, sot nuk jam i mirseardhur¹

Jakov Boshkoviç nga Çokrla, përndryshe kushëri i afërm i Boshkos, foli me neveri për atë ngjarje. Boshkoja vinte shpesh ta vizitonte. Ato dite Boshkoja shkoi edhe tek Jakovi. Ata folën kryesisht për politikë. Ai nuk dëshironte të qëndronte në konvikt, por tha se i kishte premtuar Dimitrije Bulatoviçit që ta vizitonte në Shahoviç. Kanë diçka për të folur. Ai do të qëndrojë atje në shtëpinë e konviktit dhe të nesërmen do të vazhdojë për në Mojkovac përmes Cerit me Luken dhe Miletën, kusherirët nga Potrku. Ashtu edhe ndodhi. Të nesërmen, nëpër Vraneç u përhap lajmi se Boshkoja kishte vdekur dhe se varrimi do të bëhej në Pole. Jakovi shkoi në varrim së bashku me disa të afërm dhe fqinjë. Para se Jakovi të kthehej nga varrimi, u përfol se myslimanët kishin vlarë Boshkon dhe ai duhej të hakmerrej menjëherë. Jakovi u kthye me shpejtësi në shtëpi. Kur arriti në Shahoviç, ai tashmë dëgjoji të shtëna dhe pa tym nëpër Potrk. Ai vrapoi me kalë në Muslliq dhe u ndal nga kumbari i tij Amir Muslliq, i cili e përshëndeti me fjalët: "Mirësejven, kumbar Jakov, më trego për vdekjen e z. Boshkos, nëse di çfarë". Pa zbritur nga kali, Jakovi i tha me një zë të ngazëlllyer: "Kumbar, unë nuk jam i mirseardhur sot tek ti, por nxitova të të rrëmbej këtu për të shpëtuar ty dhe familjen tënde. Por nuk kemi kohë të flasim. Më jep atë fëmijë mashkull para meje, dhe ju pajisni kalin dhe te shpejtojme për në Kovren me pjesën tjetër të familjes"

Kështu dhe ndodhie - diku rrugës, diku nëpër livadh, diku nëpër lumë, ata arritën në Kovren. Familja e Amir Muslliqit dhe myslimanëve të tjerë të mbledhur, me ndihmën e ushtrisë që arriti nga Plevla, u transferuan në Plevla.

▣ **Bashkangjitja nr. 4 (grupi II):**

Letër nga J. Plamenac drejtuar Serdar Janko Vukotiq²

Tani arriti një person nga Berane dhe thotë se disa oficerëve nga Berane i duhet të kalojnë në Mal të Zi, por kanë frikë për jetën e tyre. Ndërsa hynin në kufirin tonë, Turqit pothuajse të gjitha familjet e tyre i strehuan në shtëpitë tona duke kërkuar mbrojtje dhe ata i pranuan ato.

▣ **Bashkangjitja nr. 5 (grupi III):**

Sakrifikimi për të tjerët, se si Novak Ashanin shpëtoi Mustafa Musliqin, një fëmijë 12-vjeçar³

Mustafën Musliq, një djalë 12-vjeçar e shpëtuan vëllezërit Ashanin, Novak Nedjelkov dhe Vlladimir - Vllado Ashanin. Për ta shpëtuar, Novaku e vendosi në pemën e Krishtlindjes së Sekula Ashanin në Shahoviç dhe kur u krijua mundësia, ai e nxori nga pema e Krishtlindjes dhe e çoi në shtëpi.

"Sapo Mustafa hyri në shtëpinë time, ai u ul në gjunjë dhe më luti mua dhe gruan time që ta shpëtonim. Pa prituri fare, e fshehëm djalin në tavan dhe e fshehëm pas tendës së thurur në cep të tavanit. Para se u largova, iu afrova dhe i thashë të pushonte derisa të kalonte rreziku, duke e inkurajuar që asgjë e keqe nuk mund t'i ndodhte. Zbritëm nga shkallët. Novaku i nxori jashtë dhe i mbështeti në një kashtë. Nga ana tjetër, hakmarrësit hynë në shtëpi, e kontrolluan atë, por nuk gjetën asgjë. Njëri prej

1 Rastoder Šerbo, Kad su vakat kaljali insane: Šahovići 1924, Alamanah, Podgoricë, faqja 204-205

2 Biblioteka institutit historik Univerzitetit te Malit te Zi, Podgorice, K85/Istočni odred crnogorske vojske 1912, nr.358, 06.10.1912. Oblasni upravitelj iz Kolašina kom. J.Plamenac piše Serdaru Janku Vukotiću.

3 Rastoder Šerbo, Kad su vakat kaljali insane: Šahovići 1924, Alamanah, Podgorice, faqet 198-200



tyre kërkoi shkallët për t'u ngjitur në tavan. Në atë moment, Novaku hyn në derë, dhe gruaja bërtet: O Novak, ja po kërkojnë dhe shkallët, ata duan të kërkojnë nëpër tavan. Novaku me hidhërim ia preu: Unë nuk kam mish në tavan, nëse doni raki, kafe dhe djathë, uluni dhe mire se keni ardhë. Do të ishte shumë më mirë edhe për ju edhe për ne të na lini në paqe. Ata u përgjigjën: Ata na thanë se djali i Amirit kishte ikur në oborrin tuaj.

-Nëse do të kishte hyrë, ai do të ishte këtu, por edhe sikur të ishte këtu, nuk do t'ju lejoja ta nxirrnit nga shtëpia ime, me kusht që e mbuloni me gjak te gjithën.

- Ju paralajmërojmë të mos silleni ashtu, nuk do të jemi të mëshirshëm me ju.

Nipi i të riut Novak Vladimir - Vllado i inatuar u paraqit me shpejtësi te dera. Pa pyetur askënd, ai vuri dorën në kolt, duke thënë: -Ju lutem ndërhyrës, dilni jashtë. Novaku e qetësonte, por Vlladoja vazhdoi: - Dilni menjëherë nga shtëpia, dhe nëse dikush prek armën, do të qëlloj.

Të tre hakmarrësit me zemërim largohen nga shtëpia dhe duke kërcënuar përplasën derën. Pasi u larguan, Novaku kërkoi nga Qeveria që ta merrte Mustafën me kalë dhe ta çonte në Plevla, ku po grumbulloheshin një masë refugjatësh myslimanë."

Bashkangjitja nr. 6 (grupi III):

Ai vdiq duke kryer detyrën e tij njerëzore⁴

Më 21 janar 1993, një grup anëtarësh të Ushtrisë së Republika Srpska identifikoi persona në tregun e Trebinjes. Pasi zbuluan se një nga personat e legjitimuar, Alen Gllavoviq, ishte një boshnjak, ata filluan ta malltregonin dhe ta rrahnin. Pastaj Srgjani erdhi në ndihmë të Gllavoviqit dhe në vend të Gllavoviqit, katër ushtarë e rrahën Srgjanin me kunjat e pushkës. Si rezultat i rrahjeve, Srgjani ra në koma dhe vdiq më 27 janar 1993. Babai i Srgjanit shkroi në nekrologjinë "Ai vdiq duke kryer detyrën e tij njerëzore". Duke qëndruar në përputhje me virtytet themelore njerëzore, babai i Srgjanit, Rade, mblodhi forcat ditën e varrimit në varrezat plot njerëz dhe iu drejtua të pranishmëve: "Rini, juve po ju drejtohem, sepse ju jeni këtu ne numrin më të madh. Shikoni, ka tuma të vëllezërve tuaj përreth. Kur e ula Vujën tim në këtë varr më pak se një vit e gjysmë më parë, ishte sikur kjo e keqe kishte filluar atëherë. Këtu, duke ulur Srgjen tim në të njëjtin varr, shpresoj se kjo e keqe do të ndalet me kaqë ... Sot është jashtëzakonisht e vështirë për mua, sepse shumë miq, të njohur dhe bashkëqytetarë vijnë për të më shprehur ngushëllime, dhe disa prej tyre më përshëndesin sepse ata po largohen nga ky qytet dhe mund të mos kthehen më kurrë në të..."

4 <https://magazinplus.eu/srdan-aleksic-umro-je-vrseci-svoju-ljudsku-duznost/>

Shqiptarët - origjina, mënyra e jetesës dhe rruga për pavarësi

MËSUESI	Valentina Knezheviq	Dr Dragisha Ivanoviq	
NJËSIA MËSIMORE	Historia	VII	
UDHËZUES I ORËS	Dy orë të mësimimit (90 min.)		
LËNDA MËSIMORE	Historia	KLASA	VII
TEMA E ORËS	Shqiptarët - origjina, mënyra e jetesës dhe rruga për pavarësi Material është për nxënësit e klasës VII dhe VIII		
QËLLIMET	Nxënësit do të kuptojnë dhe mësojnë për ngjarjet më të rëndësishme të historisë komplekse të shqiptarëve deri tek pavarësia e tyre. Nxënësit e kuptojnë çështjen kombëtare shqiptare.		
REZULTATET E MËSIMIT	<p>Deklarojnë origjinen shqiptare;</p> <p>Rendisin shtetet në Mesjetë që ishin të interesuar për territoret e banuara nga shqiptarët;</p> <p>Përshkruajnë jetën e shqiptarëve në mesjetë (kultura, zakonet, mënyra e jetesës...);</p> <p>Veçojnë fiset më të famshme shqiptare dhe periudhat në të cilat kanë udhëhequr në mënyrë të pavarur pjesët e territoreve shqiptare;</p> <p>Analizojnë faktet që paraqesin Skënderbeun si një figurë kryesore të fisnikërisë shqiptare;</p> <p>Shpjegojnë arsyet e pranimit të Islamit nga popullata shqiptare pas pushtimit osmanë;</p> <p>Vlerësojnë lindjen e lëvizjes kombëtare midis shqiptarëve (Lidhja e Prizrenit);</p> <p>Krahasojnë pavarësinë e shqiptarëve nga Perandoria Osmane me shtetet e tjera të Ballkanit.</p>		
FORMA DHE METODA E PUNËS NË ORË	Hulumtim, dëftuese-ilustruese, dialogë/monolog, diskutim, harta e mendjes; Punë në grupe, frontal, individual		
Mjetet mësimore	Projektor, harta, libri shkollor, fletë pune, dërrasa e zezë, shumës		
LITERATURA			
Web link			
Korrelacioni	Gjeografia, informatika, edukimi muzikor		

Përmbajtja (rrjedha) e orës

Përgatitja e nxënësit - hyrje në temë ose njësi

RRJEDHA E ORËS:	<ul style="list-style-type: none"> • Aktiviteti 1
AKTIVITETI I HYRJES	<p>Në pjesën hyrëse në orë, mësuesi u tregon nxënësve një pjesë të filmit dokumentar Shqiptarët në Mal të Zi dhe prezanton temën e orës.</p> <p>https://youtu.be/tZZGQde7rco Shqiptarët në Mal të Zi</p>
	<p>Punësoria ka tre faza: Faza e parë është hyrja dhe puna në grupe, faza e dytë është prezantimi i rezultateve. Kurse faza e tretë është përsëritja përmes hartës së mendjes.</p>
AKTIVITETI KRYESORË	<ul style="list-style-type: none"> • Aktiviteti 2 <p>Mësuesi i ndan nxënësit në grupe, ndan materialin dhe u shpjegon detyrat;</p> <p>Grupi I: Origjina e Shqiptarëve;</p> <p>Grupi II: Jeta e Shqiptarëve në mesjetë;</p> <p>Grupi III: Skënderbeu, figura udhëheqëse e fisnikërisë shqiptare;</p> <p>Grupi IV: Lindja e lëvizjes kombëtare midis shqiptarëve dhe krijimi i pavarësisë.</p>
AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR	<p>Bëjnë hartë mendje (5minuta)</p> <p>Prezantojnë hartën e mendjes (2-3 nxënës, varet nga koha)</p>
Aktivitetet e nxënësit	<p>Prezantojnë, dëgjojnë në mënyrë aktive, bëjnë/përgjigjen pyetjeve, komentojnë, diskutojnë, zgjedhin shoqatën...</p> <p>Zgjatja e orës është caktuar për dy orë.</p>

Kuptimi i domethënies

Grupi I – Origjina e Shqiptarëve

Burimi 1. Kalaja mesjetare e Krujës

Fqinjët tanë të parë lindorë, shqiptarët, nuk kishin shtet në Mesjetë. Ata rrjedhin nga vendasit e Gadishullit Ballkanik. Qendra e zonave shqiptare ishte rajoni malor i Arbanonit rreth qytetit të Krujës. Nga emri i kësaj zone, rrjedh emri i këti populli, Arbanez (Shqiptarë).



Kruja njihet si kalaja e Gjergj Kastriot Skenderbeut, heroit nga koha kur qyteti rezistonte me këmbëngulje ndaj Turqve osmanë.

Historia, Klasa 6, ZZUNS, Podgorica, faqja 74.

Burimi 2.

Kalaja e Krujës është fortesë eliptike në majë të shkëmbit të lartë 804 m, e cila mbulon një sipërfaqe prej 2.5 hektarësh. Gërmimet arkeologjike nga viti 1978 tregojnë se kodra ka qenë e banuar që nga shekulli i III-të para Erës së re, ndërsa kalaja e parë është ndërtuar në shekullin e V-të. Kalaja e sotme përmendet në shekullin e IX-të së bashku me qytetin e Krujës si qendra peshkopale. Gjatë periudhës së sundimit të Skënderbeut në shekullin XV-të, kalaja u bë fortesë shqiptare - kështjellë.


www.intoalbania.com. Intoalbania, 2018.

- Përshkruani kalanë dhe tregoni rëndësinë e saj e mbrojtjes kundër armikut.
- Si i ruajti veçoritë popullore shqiptare në Mesjetë edhe pse ishte nën sundimin e shteteve të tjera?

Burimi 3.

Zona e Krujës

Në lidhje me pozitën gjeografike të Krujës, cilat vende ishin të interesuara për territoret e banuara nga Shqiptarët?



www.albanian.com/information/history/index.html

Grupi II - Jeta e shqiptarëve në mesjetë (kultura, zakonet, mënyra e jetesës....)

Burimi 1.

Besa

Besa është lidhja e fortë, disiplinë në të cilën jeta kryhet ndaj detyrimit ligjor. Gruaja i premtos jetën burrit të saj se nuk do të tradhtojë dhe nuk do të vendosë trashëgimtarë tjerë. Familja, »skllëvërit« i premtojnë jetën Zotit të shtëpisë se do ta respektojnë si Zotin. Personi i borxhit të gjakut i premtos jetën dhe jep besën se do të respektojë gjakun e falur dhe se nuk do të hakmerret. Mbrojtësi i besës premtos jetën borxhliut në rrugën e hakmarrjes. I zoti i shtëpisë i ja premtos jetën djalit që të fejuarë e djalit nuk do ja jap dikuj tjetër. Në asambljetë fisnore vëllazërore, jepet besa se vendimet do të respektohen: se nuk do të ketë tradhti bashkëshortore, se nuk do të lypet dora e vajzës së fejuar, se nuk do të grinden, vrasin, plaçkisin, grabisin, vjedhin, se do i mbajnë rrugët e lira, si dhe kullotat malore, ujitjet, etj. Jepet besa në treg se borxhet do të paguhet në kohë, etj.

(Fragmente nga libri Milutina Đuričića Zakonet dhe besimet e shqiptarëve, botimi i autorit, Beograd, 1994)

- Bazuar në tekst, konkludoni, çfarë do të thotë fjala besa në gjuhën tonë?
- Sa e rëndësishme është besa për Shqiptarët?
- A e mbajnë Shqiptarët sot besën?

Burimi 2.

Kombi dhe feja

Ata nuk urrejnë njëri tjetrin, edhe nëse i pagëzuari do donte që vëllai nuk do të ishte turqizuar, por tani nuk mund ta sjell mbrapa, po edhe të kishte mundësi ta pagzojë, vëllai do humbte vlerën, ashtu siç e kanë hu-



mbur shumë njerz, duke u thënë të tillëve: “Mjafton të poshtërosh veten një herë dhe të ndryshosh fenë, e të kalosh nga besimi në besim, si i verbëri nga dera në derë». Pra do të preferonte ta ketë vëllanë Turk, e mos të jetë në çdo anë e ti thonë: “Këta asnjë fe nuk e mbajnë”. Dhe kështu ata mbahen dhe vdesin njëri për tjetrin. Por ata sado që një besim i ka lidhur, aq nevoja i ka mësuar se feja nuk ka rëndësi për të mbajtur vëllazërinë, por gjithashtu forcoi dhe siguroi jetën, dhe i ndihmoi ata të mos e urrenin njëri-tjetrin për hir të turqizmit, sepse ai do donte edhe një turk tjetër në qoftë se ja mbron jetën dhe ndan të keqen dhe të mirën me të, e jo vëllaun e vet, në vend të cilit nuk mund të ketë një tjetër të cilit në telashe do ti thonte: “Më ndihmo, vëlla”. Vetëm sepse ai ndryshoi besimin, nuk do të thotë që nuk është vëlla, as se e harroj gjakun e tij, por ka diçka që nuk e lë vëllain e tij të harrojë, kur vëllaun e sheh në telashe ai vrapon për ta ndihmuar dhe me të vdes. Kur është në gjendje të mos e kursejë jetën për vëllan e vet, pse për besim të ndryshëm ta lë dhe ta harrojë - sado të urrente besimin, vëllaun nuk e urren dot. Dhe kush ka zemër ta urrej vëllan, ai do i lejojë vetes të urrejë të dy besimet, edhe nese nuk do ishte nevoja e ndihmës së vëllaut, e jo kur është nevoja, do ta bind fjala e urtë që thotë: “Vëllau të ka- nuk të njeh; të humb-të njeh!

Pra, siç kam thënë, ata para njëqind vitesh kanë nisë të turqizohen, e mundshme për shumë shkaqe dhe me të vogla, të cilat më vonë u bënë më të mëdha. Por në fillim të turqizimit të tyre, ku kish-te vëllazëri, në fillim ata nuk ranë dakord për fe, si më vonë, por u urrenin me njëri tjetrin; kur njëri turqizohet, pse mos të turqizohet edhe tjetri, ndërsa tjetri thoshte pse të turqizohet edhe ai. Dhe kështu, dy besimet kanë mundur përgjithmonë të vëllazërohen. Por kur njëher vjen rreziku nga armiku dhe sheh vdekjen para syve, vëllau bërtiti: “Mos më lësho, vëlla, se më vrane!” Vëllau kur ndjen dhe e sheh vëllan në rrezik, harrohet besimi, vlon gjaku, dhe derdhet së bashku me gjakun e armikut. Me këtë akt sytë dhe mendja u bindën se vëllau pa vëlla nuk mundet.

Marko Milanov Popoviq, JETA DHE ZAKONET E SHQIPTARËVE

- Cilat ishin arsyet që popullata të kalojë në Islam?
- Si ndikoi adoptimi i Islamit në marrëdhëniet midis popullatës?

Burimi 3.

Gruaja

Tek ata, nusja e re i shërben familjes dhe miqve, duke qendruar në këmbë, gjithmonë e gatshme. Sa do që të kishte fëmijë dhe të ftuar, ajo është shërbëtorja: të vëreje dhe gjën më të vogël, kush ku e ka vendin dhe ku duhet të ulet; të jetë aty nëse kërkon kush të pijë ujë, dhe të ja jape; kush e mbush çubukun me duhan, nusja me kapsa hekuri, që mban rreth belit, në secilin çubuk vën qymyr nga zjarri, kështu edhe nëse ka njëqind njerëz në shtëpi, siç ndodh, sepse është zakon si tek ne ashtu edhe tek ata të mbledhen fshatarët, të rinjtë të vallzojnë e të këndojnë, kurse të moçmit të bisedojnë e të pijnë duhan e të shikojnë kush kërcen më së mirit, kurse të ritë grabiten cili do të lavdërohet më shumë nga të moçmit.

Shtëpiat ku mblidhen më së shumti janë kryesisht ato ku nusja u soll atë vit. Ajo shërben të gjithë, siç tha-shë: të mirët dhe të keqinjtëit, fëmijët që rrin aty, me fjalë të tjera magjypit më të keq ose ushtarit më të mirë, ajo është e detyruar ti shërbejë barabartë, është për tu habitur, si rob i pafatë duhet ti arrije të gjitha, pesëmbëdhjetë grua po të ishin të gjitha do kishin punë, e ajo duhej ti bëj të gjitha vetë ose të turpërohet!

Marko Milanov Popoviq, JETA DHE ZAKONET E SHQIPTARËVE

Burimi 4.

Gratë në Shqipëri (rreth vitit 1810)

Ata i trajtojnë gratë e tyre, të cilat janë pothuajse të gjitha plotësisht të paarsimuara dhe nuk flasin ndonjë gjuhë tjetër përveç gjuhës së tyre amtare, në të njëjtën mënyrë si bagëtinë, kështu edhe në

këtë mënyrë i përdorin (por si bagëti të sortës së mirë), i përdorin për punë të vështirë, dhe shpesh i dënojnë me rrahje. Në të vërtetë, kultivojnë përçmim për gratë e tyre, mbase edhe urrejtje, madje edhe në shprehjet e herëpashershme të dashurisë nuk ka asgjë që ngjante nga larg me atë që e quajmë butësi. E megjithatë, secili prej tyre martohet nëse mundë, sepse është shenjë e prosperitetit, dhe gjithashtu sepse dëshiron të ketë rob në shtëpi. Përveç kësaj, si në pjesët e tjera të vendit, gratë nuk janë aq të shumta sa burrat, kështu që nusja shpesh nuk i sjell burrit të saj një pajë, por ai ia jep asaj, dhe duhet të mbledhë rreth një mijë grosh para se të mund të mendojnë për martesë

Broughton, faqja 136

Libri shkollor 1, Perandoria Osmane, ZZUINS, Podgoricë 2012, faqja 98

- Pse janë gratë e përmendura në këtë tekst në pozitë kaq të keqe?
- Çfarë autorët e teksteve mendojnë për këtë?
- Si është pozicioni i grave në Mal të Zi sot?

Burimi 5.

Ushqimi dhe pija në Shqipëri (rreth vitit 1810)

Ushqimi kryesor i këtyre njerëzve është buka e grurit ose thekrës ose proja prej miellit të misrit, pastaj djathi prej qumështit të dhisë, orizi i përzier me gjalpë, vezë, peshku i tharë, ullinj dhe perime. Për festa, theren qengja dhe dele, si dhe shpendët, të cilët janë kudo; megjithatë, mishi përbën pjesë shumë më të vogël të ushqimit se të tjerat. Si myslimanët ashtu edhe të krishterët pinë verë, si dhe pije alkoolike të fortë të bërë nga bollëku dhe elbi, e quajtur raki, e cila i përgjan uiskit. Por për shkak të gjithë ati djathi rrallë ruajnë qumësht. Kryesisht pijnë ujin e ftohtë, në gllënjka të mëdha, madje edhe në mes të verës dhe gjatë punës më të vështirë, ku pas kësaj nuk kanë probleme. Kafe ka në shumë shtëpi, në disa vende liker nga Kefalonia dhe Korfuzi.

Broughton, faqja. 130

Libri shkollor 1, Perandoria Osmane, ZZUINS, Podgoricë 2012, faqja 98

- Krahasoni mënyrën e të ngrënit me të sotmen në vendin tonë?
- Jep konkludim se me çfarë është marrë popullata shqiptare?
- Si jetojnë shqiptarët në mesjetë?

Grupi III – Gjergj Kastriot Skenderbeu, figura udhëheqëse e fisnikërisë shqiptare.

Burimi 1.

Skenderbeu udhëheqi në mënyrë të pavarur 25 vjetë një pjesë të Shqipërisë. Gjatë asaj periudhe, ai me guxim dhe sukses iu kundërvu osmanëve, prandaj fitoi famë të madhe.

- A vëreni ndonjë gjë të pazakontë në foto?

Burimi 2.

Crnojeviqët dhe Gjergj Kastriot Skenderbeu

<https://www.youtube.com/watch?v=uqiNKGVBV5c>

- Përshkruani lidhjet e ngushta midis Crnojeviqëve dhe Skenderbeuta.



➔ Libri shkollor, Historia 7, ZZUNS, Podgoricë, faqja 35



Burimi 3.

Rëndësia e flamurit shqiptar, fjalimi i peshkopit Fan Stlijan Noli në varrimin e Faik Konicës (1942)

Më lejoni të them disa fjalë për flamurin e shqiptarëve. Siç e dini të gjithë, asnjë flamur i fqinjëve tanë në Ballkan, nuk është më i vjetër se një shekull e gjysmë. Disa prej tyre janë më të rinj se një shekull. Flamuri ynë është më se 500 vjet i vjetër. Ishte ky flamur i Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, heroit kombëtar të shqiptarëve, i cili luftoi kundër turqve për më se një çerek shekulli dhe ishte luftëtari i krishterë i fundit në Ballkan që me sukses i mposhti sulltanët e Turqisë. Pas vdekjes së Skënderbeut, fuqitë evropiane e lanë Shqipërinë pas dore që domosdo u nënshtroa. Shqipërisë pastaj iu desh të rënkojë për nja 4-5 shekuj nën zgjedhë otomane. Gjatë kësaj kohe flamuri i Skënderbeut ishte harruar. Askush nuk dinte për ekzistimin e tij deri në momentin kur një shkollari i ri e vendosi në një bibliotekë latine për Skënderbeun. Ai shkollari i ri ishte Faik Konica, dhe flamuri me shqiponjën dy krenare, që tash e ka mbuluar arkivolin e Faik Konicës, është flamuri që ai e rizbuloi.

Konitza 2000, faqja 174

Libri i historisë 2, Kombet dhe Shtetet në Evropën Juglindore, Podgoricë 2012, faqja 99

Burimi 4.

- Çfarë dini për Gjergj Kastriotin?
- Veço faktet që tregojnë Sknderbeun si person që udhëheqi fisnikërinë shqiptare
- Çfarë na tregojnë simbolet në flamurin e Shqipërisë?



Grupi IV - Lindja e lëvizjes kombëtare midis shqiptarëve dhe krijimi i pavarësisë

➤ www.albanian.com/information/history/index.html

Burimi 1.

Lëvizjet nacionalçlirimtare midis popujve ballkanikë dhe dobësimi gjithnjë e më i dukshëm i Perandorisë Osmane ndikuan në formimin e ndërgjegjes kombëtare të popullit shqiptar. Shqiptarët u ndërgjegjësuan se pa një program të unifikuar kombëtar, qëllimet e bashkimit kombëtar nuk mund të arriheshin. Kur u njoftua mbajtja e Kongresit të ardhshëm të Berlinit të Shteteve Evropiane dhe Perandorisë Osmane për të rishikuar Traktatin e Sanstefanos, udhëheqësit politikë shqiptarë thirrën asamblen (10 qershor 1878) në Prizren. Lidhja e Prizrenit u formua me qëllim të përcaktimit të udhëzimeve për veprime të mëtejshme politike. Rreth 300 përfaqësues u mbledhën në Prizren nga të gjitha territoret e populluara nga shqiptarët, përfshirë Epirin, Maqedoninë, Kosovën, Sanxhakun, Serbinë e Jugut dhe Malin e Zi.

Përbërja e larmishme e asamblesë shpejt çoi në ndarjen në dy rryma: pro-osmane dhe autonome. E para përbëhej nga feudalët, udhëheqësit fetarë dhe tregtarët e pasur, të cilët nuk mund të imagjinonin mbijetesën e tyre jashtë protektoratit të Portës, ndërsa rryma e dytë përfaqësohej nga intelektualë shqiptarë që donin pavarësinë dhe mbështetjen në dy fuqitë kryesore evropiane: Austro-Hungariane dhe Italiane. Kjo ndarje më vonë do të çonte në përçarje brenda vetë Lidhjes. Përfaqësuesit e Lidhjes (15 qershor 1878) i dërguan një memorandum fuqive të mëdha në Kongresin e Berlinit duke kërkuar vendosjen e integritetit shtetëror të territorit shqiptar, duke marrë parasysh vendet e popujve të tjerë të Ballkanit të banuar nga shqiptarë. Sidoqoftë, në kongresin e Berlinit, çështja shqiptare u ngrit si çështje e brendshme e Perandorisë Osmane dhe nuk zgjidh nga fuqitë e mëdha.

Histori për klasën I dhe II të shkollës së mesme, Zhelko Drinçiq, Zdravko Pejoviq, ZZUNS, Podgoricë 2003, faqja 174

- Përshkruani rëndësinë e Lidhjes së Prizrenit në mbrojtjen e kombit shqiptarë.
- Cili ishte fati i Lidhjes së Prizrenit?

Burimi 2.

Këngë shqiptare e shkruar gjatë Kongresit të Berlinit (1878)

Ju lutem keni kujdes
me Shqipërinë,
Mos e shqyeni
Si jetim,

Sepse ne nuk jemi as grekë, as bullgarë,
As malazezë,
Ne jemi thjesht shqiptarë
Ne duam vetëm liri.

Brahimi, str, 62

Libri i historisë 2, Kombet dhe Shtetet në Evropën Juglindore, Podgoricë 2012

Ashtu si kombet e tjera të Ballkanit, shqiptarët nuk kishin përfaqësues në Kongresin e Berlinit, por udhëheqësit shqiptarë gjithashtu u përpoqën të përcaktonin qëllimet kombëtare dhe të fitonin opinionin publik për ato qëllime.
Cili është qëllimi i kësaj kënge?

- Çfarë dëshiron të thotë poeti duke renditur emrat e njerëzve që jetojnë në zonën ku ai jeton?

Burimi 3.

Shpallja e pavarësisë shqiptare në Vlorë (1912) – gdhendje nga ajo periudhë

- Cili është elementi kryesor në këtë gdhendje?
- Pse momenti i shpalljes së pavarësisë është i lidhur me simbolet kombëtare?
- Cili është roli i Skënderbeut në këtë fotografi?

**Burimi 4.**

Himni i Shqipërisë/Himni i Flamurit (1912)

Rreth flamurit të përbashkuar
Me një dëshirë e një qëllim,
Të gjith' atij duke u betuar
Të lidhim besën për shpëtim.
Prej lufte veç ai largohet
Që është lindur tradhëtor,
Kush është burrë nuk frigohet,
Por vdes, por vdes si një dëshmor!
Në dorë armët do t'i mbajmë,
Të mbrojmë atdheun në çdo kënd,
Të drejtat tona ne s'i ndajmë;
Këtu armiqtë s'kanë vënd!
Se Zoti vetë e tha me gojë
Që kombe shuhen përmbi dhe,
Po Shqipëria do të rrojë;
Për të, për të luftojmë ne!

➤ Libri i historisë 2, Kombet dhe Shtetet në Evropën Juglindore, Podgoricë 2012, faqja 51

www.albanian.com/information/history/index.html



Vargjet janë shkruar nga Alex Stavre Drenova alias Asdreni (1872-1947). Drenova kaloi pjesën e jetës së tij në Rumani dhe vdiq në Bukuresht. Titulli origjinal i këngës është *Betimi mi flamurit*, dhe u botua për herë të parë në 1912 në gazetën *Liri e Shqipërisë*, gazetë shqiptare që u botonte në Sofi. Dy strofat e para, me muzikën e *Cyprusian Porumbescu* (1853-1883), u shpallën himni shqiptarë në 1912.

Libri i historisë 2, *Kombet dhe Shtetet në Evropën Juglindore*, Podgoricë 2012, faqja 101

- Çfarë dini për himnin e vendit tënd?
- Diskutoni, analizoni dhe konkludoni (zhvilloni mendimin kritik)

Reflektimi

Aktiviteti 3.

Bëjnë hartë mendje (5 minuta)

Prezentojnë hartën e mendjes (2-3 nxënës, varet nga koha)


Shënim :

Nëse mbetë kohë e lirë, ata bëjnë (fillojnë) një hartë mendje në klasë, dhe e përfundojnë si detyrë shtëpie.

Në fund të orës, disa nxënës mund të luajnë vallen shqiptare »Shota». Disa nxënës mund ti shoqërojnë me flautë (zakonisht ka nxënës në klasë që luajnë folklor).



Shqyrtimi i realizimit



Shqiptarët në Mal të Zi



MËSUESI	Sait Sh. Shabotiq	IP SHF "Milleva Lljajović Ljallatović", Nikshiq	
NJËSIA MËSIMORE	Shqiptarët në Mal të Zi	IX	
UDHËZUES I ORËS	Një orë e mësimi (45min)		
LËNDA MËSIMORE	Historia	KLASA	IX
TEMA E ORËS	<i>Mali i Zi në Jugosllavi dhe rimarrja e pavarësisë së Malit të Zi</i>		
QËLLIMET:			
Edukative	Përvetësimi i njohurive themelore për shqiptarët në Mal të Zi; njohja me traditën, kulturën dhe gjuhën shqiptare.		
Arsimore	Zhvillimi i qëndrimit kritik ndaj ngjarjeve të kaluara; Mësimi dhe ushtrimi në tabelat e grafikëve.		
Funksionale	Zhvillimi i aftësisë për të zhvilluar shkak-pasojë mardhënie; Motivimi për të njohur popuj të ndryshëm dhe kulturat e tyre dhe për të krijuar qëndrime pozitive midis anëtarëve të grupeve të ndryshme etnike dhe shoqërore; ushtrime në analizën e materialeve me origjinë dhe përmbajtje të ndryshme.		
REZULTATET E MËSIMIT	<p>Nxënësi/ja do mund të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkruajnë për poziten e shqiptarëve pasluftës dhe në Malin e Zi modern; • Analizojnë të dhënat demografike në lidhje me pakicën e kombit shqiptar; • Krahasojnë të dhënat demografike në lidhje me shqiptarët me të dhënat e komuniteteve tjera kombëtare në Mal të Zi; • Përcaktojnë përkatësinë fetare dhe gjuhësore të shqiptarëve; <p>Shpjegojnë kontributin e pakicës kombëtare shqiptare në përparimin shoqëror dhe ekonomik dhe rikthimin e pavarësisë së Malit të Zi;</p>		
FORMA DHE METODA E PUNËS NË ORË	<p>Monolog; ilustrues-dëftor; dijalog</p> <p>Frontal; Punë në çifte.</p>		
Mjetet mësimore	Libri i historisë për klasën e IX të shkollës fillore; harta (Zhvillimi teritorial i Malit të Zi); Lap top ; projektori; ekrani i projekcionit; tabela		
LITERATURA	Slavko Burzanović/ Jasmina Đorđević, Istorija 9, Udžbenik istorije za deveti razred osnovne škole, Zavod za udžbenike i nastavna sredstva Podgorica, Podgorica 2020; Peter Bartl, Istorija Albanaca, Clio, Beograd 2001; Istorijski leksikon Crne Gore, knj. 1, Podgorica 2006.		
Web link			
Korrelacioni	Korrelacioni me lëndët e tjera: serbe-malazeze, gjuha boshnjake dhe kroate – fjalori; Kultura e artit – motivet nga zona malore; ndërtimi, poster; Gjeografija – përkatsia e zonës administrative; Edukimi qytetar – tejkalimi i paragjykimeve.		



Përmbajtja (rrjedha) e orës

Përgatitja e nxënësit - hyrje në temë ose njësi

RRJEDHA E ORËS:	-Aktivitetet e mësuesit
AKTIVITETI I HYRJES	<ul style="list-style-type: none">Regjistrimi i rezultatit të orës; regjistrimi i nxënësve që mungojnë; Thirje për nxënësit të përgatiten për orë.Motivacioni: Mësuesi ka në duar kopjen e shtypur të fotos së njohur Pajes Jovanović – „Na mejdan“. Duke ecur, kërkon nga nxënësit të shkruajnë në një copë letër katër fjalë që u vijnë ndërmend ndërsa shikojnë ilustrimin e treguar. Kur nxënësit të bëjnë këtë gjë, mësuesi kërkon që ta lënë letren menjëanë. Shkurt kujton se në Mal të Zi jetojnë kombe të ndryshme (shpall temën) ndër të cilët janë edhe Shqiptarët.
AKTIVITETI KRYESOR	<ul style="list-style-type: none">Definon dhe thekson qëllimin e orës;Në pika të shkurta përmbledh të kaluarën e Shqiptarëve. Ai vëren se për shkak të ndryshimeve të ndryshme historike dhe politike, një pjesë e popullsisë shqiptare mbeti për të jetuar brenda kufijve të Malit të Zi të sotëm.(tregon bashkangjitet ilustruese (nr. 1, 2) dhe kërkon interpretimin e tyre duke përdorur teknikën (çfarë shoh, si interpretoj, mesazhi i fotografisë dhe mesazhi im“)Me ndihmën e laptopit, shfaq dhe tregon hartën etnike të Malit të Zi. Tregon në hartë zonën kryesore e popullimit shqiptarë në zonat kufitare të Malit të Zi të sotëm (bashkangjitet ilustruese (nr.4).Me ndihmën laptopit, tregon fotot e qyteteve malazeze ku jeton popullata shqiptare.Shpall të dhënat për popullsinë shqiptare në Mal të Zi për tre regjistrimet e fundit (1991, 2003, 2011) si dhe të dhënat për numrin e Malazezëve, Kroatëve, Boshnjakëve, Serbëve dhe Myslimanëve; Tregon të dhënat për numrin e shqiptarëve në disa komuna: Ulqin, Tuz, Podgoricë, Plavë, Rozhaje, Tivarë. Në Mal të Zi nga bashkitë (Tabela nr.1; tabela nr.2) <p>-U cakton detyrën nxënësve, duke theksuar se do të punojnë në çift.</p> <ol style="list-style-type: none"><i>Shpjegoni origjinen e Shqiptarëve?</i><i>Tregoni se në cilat qytete të Malit të Zi sot shqiptarët përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së përgjithshme dhe shpjegoni pse?</i><i>Ndani vitet në të cilat popujt pakicë në Mal të Zi arritën kulmin e tyre demografik. Të dhënat demografike për shqiptarët për tre regjistrimet e fundit paraqitni në formën e diagramit. Nxirrni përfundimin.</i>



AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR	<ul style="list-style-type: none">▪ Mësuesi kërkon përgjigjen nga disa çifte;▪ Shpjegon pozitën e shqiptarëve në Mal të Zi pas Luftës së dytë Botërore (gjuha, tradita, feja);▪ Tregon migrimin e shqiptarëve nga Mali i Zi dhe drejtimet e flukseve të migrimit;▪ Tregon të dhënat për arsimin dhe institucionet arsimore që morën pjesë në arsimimin e Shqiptarëve; Flet për integrimin e shqiptarëve në shoqërinë malazeze;▪ Numëron përfaqësuesit më të njohur kulturorë shqiptarë që punojnë në Mal të Zi.▪ U cakton detyrë nxënësve, duke theksuar se do të punojnë në çift.<ol style="list-style-type: none">1. <i>Përshkruani pozitën e shqiptarëve pasluftës në Mal të Zi?</i>2. <i>Renditni shkaqet e migrimit të popullit shqiptarë nga Mali i Zi?</i>3. <i>Lidhni fjalët në vazhdim nga gjuha shqipe me fjalët nga gjuha malazeze: Faleminderit Naten e mirë; Qyteti; Në gjuhë Malazeze – Grad; Hvala; Crnogorac; Laku noc.</i>▪ Mësuesi kërkon përgjigjen nga disa çifte;▪ Kërkon nga nxënësit të lexojnë fjalët që shkruan në fillim të orës së mësimi duke parë ilustrimin;▪ Kërkon nga nxënësit të identifikojnë fjalët kyçe që përbëjnë përmbledhjen e orës;▪ Me ndihmën e fjalëve kyçe dhe nxënësve, mësuesi sistemon njësinë mësimore të përpunuar;▪ Udhëzon nxënësit të mësojnë fakte të reja (Leksiku historik i Malit të Zi, libri 1, Podgoricë 2006, faqet 20-22).▪ Cakton deytren e shtëpisë: Bazuar në të dhënat për popullsinë shqiptare sipas qyteteve, llogaritni pjesën e shqiptarëve në popullsinë totale të secilës komunë veç e veç. Të dhënat paraqitni në diagram.
------------------------------------	--



Aktivitetet e nxënësit

-Pjesa hyrëse e orës (5min)

- Marrin pjesë në regjistrimin e nxënësve që mungojnë; Bëjnë gati pajisjet për orë;
- Dëgjojnë me kujdes udhëzimet e mësuesit;

Shkruajnë shoqatat individualisht në letër.

-Pjesa kryesore e orës (30min)

- Me kujdes dëgjojnë prezantimin e mësuesit;
- Vëzhgojnë ilustrimet; Mendojnë; Komentojnë.
- Gjejnë në hartën e treguar në ekranin e projeksonit atë që mësuesi tregon me gojë.
- Vëzhgojnë; njohin vendbanimet qytetare; Ata shkruajnë në fletore dhe fletë pune;
- Nxënësit dëgjojnë prezantimin e mësuesit; Ata kanë mundësi të kërkojnë sqarime për gjërat e paqarta.
- Përgjigjen me shkrim; vizatojnë diagrame; nxjerrin përfundim.
- Dëgjojnë përgjigjet e shokëve të tyre të klasës; Komentojnë mbi produktet e punës së çifteve;
- Dëgjojnë prezantimin e mësuesit.
- Me ndihmën e mësuesit, ata monitorojnë flukset migratore të popullatës shqiptare;
- Vëzhgojnë fotografitë (ndërtesa e Rektoratit, UCG, Universiteti i Ekonomisë, Universiteti i Drejtësisë)
- Vëzhgojnë fotografitë e shqiptarëve të njohur (Fatos Beqiraj, Rexhep Qosja, Senad Dresheviq...)

Pamja e tabelës: Shqiptarët në Mal të Zi

Të dhënat e regjistrimit të banorëve (Burimi: https://sh.wikipedia.org/wiki/Demografia_Crne_Gore)

Viti i regjistrimit	1948.	1953.	1961.	1971.	1981.	1991.	2003.	2011.
Numri i shqiptarëve në MZ	19.425	23.460	25.803	35.761	37.735	40.880	31.163	30.439
Numri i boshnjakëve në MZ	-	-	-	-	-	-	48.184	53.605
Numri i kroatëve në MZ	6.808	9.814	10.664	9.192	6.904	6.244	6.811	6.021
Numri i malazezve në MZ	342.009	363.686	383.988	355.632	400.488	380.467	267.669	278.865
Numri i serbëve në MZ	6.707	13.864	14.087	39.512	19.407	57.453	198.414	178.110
Numri i myslimanëve në MZ	-	-	30.665	70.236	78.080	89.614	24.625	20.537

Tabela nr. 1: Numri i bashkësive kombëtare në Mal të Zi sipas regjistrimit të v.1948-2011.

▾ Të dhëna për numrin e shqiptarëve sipas qyteteve

(Burimi: Popullsia e Malit të Zi sipas gjinisë, llojit të vendbanimit, përkatësisë kombëtare ose etnike, fesë dhe gjuhës amtare nga komunat në Mal të Zi, Byroja e Statistikave, Podgorica 2011).

Komuna	Popullsia totale	Popullsia e shqiptarëve
Ulqin	19.921	14.076
Tivar	42.048	2.515
Podgoricë	185.937	9.538
Plavë	13.108	2.475
Rozhaje	22.964	1.158
Kotorr	22.601	102
Cetinë	16.657	38
Berane	33.970	70
Nikshiq	72.443	73
Bijelo Pole	46.051	57

Tabela nr. 2: Numri i shqiptarëve në komuna në Mal të Zi në raport me popullsinë totale të komunës sipas regjistrimit të vitit 2011

▾ Gjuha shqiptare:

- Shqip –dialektet gegë dhe toskë u nënshtruan fjalimit letrar në Kongresin e Tiranës në vitin 1972

▾ Religjioni

- Në aspektin fetarë ka shqiptarë katolikë (27 %) dhe myslimanë (73 %)

▾ Migrimi

- SHBA; Vendet e Evropës Perendimore



Shqiptarët e njohur në Mal të Zi

(Izvornik: https://sh.wikipedia.org/wiki/Albanci_u_Crnoj_Gori)

- Rexhep Qosja
- Mujo Ulqinaku
- Senad Dreshëviq, kompozitor
- Baca Kurti Gjokaj
- Enver Gjokaj, aktor
- Sherif Kajoshëviq, revolucionist
- Qazim Lekiq, revolucionist
- Mahmut Lekiq, revolucionist
- Ded Gjo Luli, rebel
- Nikollë Nikprelaj, pjevaç
- Ardian Gjokaj, futbollist
- Fatos Beqiraj, futbollist
- Dritan Abazoviq, politikan
- Hajro Ulqinaku, shkrimtar




➤ Bashkangjitja nr. 1: Paja Jovanoviç, Në shesh



➤ Bashkangjitja nr. 2: Karikatura - Përgjigja e Shqipërisë ndaj kërcënimeve politike



➤ Bashkangjitja nrr. 3: Kufijtë e Shqipërisë nga viti 1913



➤ Bashkangjtitja nr. 4: Harta etnike e Malit të Zi (Burimi: https://sh.wikipedia.org/wiki/Demografija_Crne_Gore)



➤ Bashkangjtitja nr. 5: Panorama e Podgoricës



➤ Bashkangjtitja nr. 6: Panorama e Ulqinit



➤ Bashkangjtitja nr. 7: Panorama e Tivarit





↗ Bashkangjtitja nr. 8: Panorama e Plavit



↗ Bashkangjtitja nr. 9:
Panorama e Rozhajës



↗ Bashkangjtitja nr. 10: Panorama e Tuzit



↗ Bashkangjtitj nr. 11: Monumenti i
Ded Lulit në Tuzë, patriot shqiptar,
pjesmarrës i Kryengritjes së Malë-
sorëve në v. 1911.



➤ Ndërtesa e Rektoratit të Universitetit të Malit të Zi



➤ Ndërtesa e Universitetit të Ekonomisë



➤ Ndërtesa e Universitetit të Drejtisë



➤ Fatos Beqiraj, futbollist



➤ Kompozitori Senad Dreshević



➤ Rexhep Qosja, shkrimtar





Tatjana Zambata

Marina e Bokës

MËSUESI	Tatjana Zambata IP Gjirnazi Kotorr		
NJËSIA MËSIMORE	Marina e Bokës III		
UDHËZUES I ORËS	Dy orë të mësimit (90 min)		
LËNDA MËSIMORE	Historia	KLASA	II (shkolla e mesme)
TEMA E ORËS	<i>Marina e Bokës (Gjirit të Kotorrit)</i>		
QËLLIMET	kupton lidhjen e historisë lokale, regionale, kombëtare dhe botërore; zhvillon aftësinë për të menduar në mënyrë kritike dhe historike, zhvillon aftësinë për të komunikuar në mënyrë efektive; motivon për studimin e historisë kombëtare; synon tolerancën fetare dhe kombëtare		
REZULTATET E MËSIMIT	nxënësi do të jetë në gjendje të shpjegojë karakteristikat e Evropës në shekullin e mesëm <ul style="list-style-type: none">• përshkruan historinë e zhvillimit të marinës së Bokës – organizimin e esnafëve detarë në shekullin e mesëm;• tregon organizatat ekonomike, karakteristikat e ushtrisë së marinës së Bokës përmes së kaluarës;• e analizon rolin e vëllazërisë në jetën shoqërore të qytetit;• në mënyrë kritike të analizojnë rëndësinë e flotës detare për zhvillimin ekonomik të Kotorrit dhe Bokës (Gjirit) së Kotorrit;• vlerëson rëndësinë e flotës detare të Bokës në ruajtjen dhe edukimin e trashëgimisë tradicionale dhe kulturore të Bokës;• shpjegon rëndësinë e flotës detare të Bokës si një pasuri jomateriale kulturore të Malit të Zi.		
FORMA DHE METODA E PUNËS NË ORË	individual, frontal, në grupe monolog, dialog, ilustruese-dëftore, prezantimi në grup, stuhia e mendimeve/ brainstorming;		

Mjetet mësimore	PPT prezantimi, kompjuteri, projektori, tabela
LITERATURA	<ul style="list-style-type: none">• Miloš Milošević, Boka kotorska, Bar i Ulcinj od XV do XVIII vijeka, CID, Podgorica, 2018.• Dr Slavko Mijušković, Bokeljska mornarica, monografija Kotor, Grafički zavod Hrvatske, Zagreb, 1970.• Katarina Ribica, Dvanaest vjekova Bokeljske mornarice, specijalistički rad, Fakultet za mediteranske i poslovne studije, Tivat, 2017.• Š. Rastoder, Ž. Andrijašević, Kotorska mornarica, Istorijски leksikon Crne Gore, Daily press-Vijesti, Podgorica, 2006.
Web link	http://www.bokeljskamornarica.com/ http://www.museummaritimum.com/ https://www.gov.me/ResourceManager/FileDownload.aspx?rId=390646&rType=2 https://www.gov.me/ResourceManager/FileDownload.aspx?rId=390646&rType=2 - UNESCO.
Korrelacioni	zhvillimi i esnafëve mesjetarë, zhvillimi i qyteteve mesjetare në Mesdhe (komuna)

RRJEDHA E ORËS:

AKTIVITETI I HYRJES

Mësuesi udhëzon nxënësit lidhje me temën e orës së mësimi:

- Çka janë komunat mesjetare?
- Çka janë esnafët?
- Renditni faktorët që ndikuan në zhvillimin ekonomik në qytetet e Mesdheut në shekullin e mesëm?
- Çka është flota detare e Bokës?
- Që kur egziston organizimi?
- Çfarë rolit ka pasur në të kaluarën?

Mësuesi udhëzon nxënësit në temën e orës:

Flota detare e Bokës është një ndër vëllazëritë më të vjetra detare (esnafë) në botë. Sot, kjo është një organizatë përkujtimore, detyra e së cilës ishte të ruajë dhe ushqejë trashëgiminë tradicionale dhe kulturore të Kotorrit dhe Bokës (Gjirit) së Kotorrit, dikur ishte një organizatë zanate që mbledhi marinarët. Detaria dhe tregtia kanë qenë gjithmonë baza ekzistenciale e Kotorrit nga e cila varet jeta ekonomike, shoqërore dhe kulturore e qytetit. Në gjithë këto flota detare kishte një rol të rëndësishëm. Jo vetëm që ishte forca lëvizëse e zhvillimit të Bokës, por gjithashtu organizatë që kushtëzoi ndryshimet shoqërore në këtë zonë dhe zhvillimin përmes çështjeve detare të komunave bregdetare të Prçanjit, Dobrotës dhe Perastit.

Kotorri, një qytet me histori të trazuar, ka mbijetuar pushtues të shumtë, dhe flota detare është një institucion që ka mbijetuar ndryshimeve të thella ekonomike, shoqërore, politike dhe ideologjike në këtë zonë. Shekujt kaluan, sundimtarët ndryshuan, por flota detare mbijetoi, duke jetuar sipas rregullave të saj, duke u kujdesur për mirëqenien e Bokës, përmes lidhjes detare, tregtare, sociale dhe shoqërore, karakterit humanitar, si mbrojtës i traditës së Kotorrit dhe traditës familjare, ruajtjes e kostumeve tradicionale, simbol i bashkësisë të banorëve të Bokës. Koha kalon por motoja i flotës detare mbetet i njëjtë “Fides et honor” – Besimi dhe nderi.

- Rëndësia e kësaj organizate njihet në Mal të Zi dhe më tej.
- Flota detare e Bokës është e mbrojtur si pasuri jomateriale kulturore në Mal të Zi prej vitit 2013.
- Mali i Zi në v.2018 nominoi flotën detare të Bokës për regjistrim në listen përfaqësuese të UNSECO-s të trashëgimisë jomateriale të njerzimit, e cila është kandidatura e parë e Malit të Zi në UNESCO në fushën e trashëgimisë jomateriale.

AKTIVITETI KRYESOR

Në mënyrë që klasa të ketë një karakter interaktiv, ndonjëherë është e nevojshme të përgatiten si mësuesit ashtu edhe nxënësit, veçanërisht kur bëhet fjalë për tema që janë më pak të njohura ose të panjohura për nxënësit.

Nxënësve u jepen detyra kërkimore për ti punuar në grupe. Detyra e mësuesit në këtë pjesë nuk është vetëm t'u japë nxënësve temën, por gjithashtu t'i udhëzojë nxënësit se në cilat aspekte duhet t'i kushtojnë vëmendje dhe si të vijnë deri tek informacioni, literatura dhe përmbajtja në internet.

Prezantimin e nxënësit e plotëson mësuesi.

Shënim: ndodh që një grup nuk e bën detyrën në detaje, ose të humbasë ndonjë informacion të rëndësishëm, prandaj mendoj se është e dobishme që mësuesi të ketë prezantimin e vet për temat e dhëna në mënyrë që mund të përfundojë prezantimin e nxënësve.

Nxënësit prezantojnë në grupë duke u bazuar në detyrat e dhëna më par.

Grupi i parë: Flota detare e Bokës – tradita dhe historia

Organizatat mesjetare të esnafëve krijohen me qëllim për mbrojtjen dhe ndihmën e anëtarëve të tyre, përparimit të profesionit dhe puna e tyre përcaktohet pothuajse gjithmonë nga statutet. Organizatat e tilla ishin specifike në shekullin mesatar të komunave në Mesdhe dhe në Kotorr.

Kur bëhet fjalë për krijimin e një organizate esnafë të marinarëve në Kotorr, nuk mund të shmanget një traditë me rrënjë të thella.

Tradita përmend shekullin e IX kur ndodhi shpengimi dhe transferimi i trupit të shenjtit mbrojtës të qytetit të Shën Trifunit, ku përmendet edhe emri i Andrazia Saracenis, i cili pagoj reliket e shenjtorit nga tregtarët venedikas dhe për nder të tij ndërtoi kishën e Shën Trifunit në v. 809. Tradita gjithashtu përmend një grup marinerësh që sollën relike në qytet dhe luajtën vallen për nder të tij.



Marinerët e Bokës viti 1905.

Nuk mund të përjashtohet mundësia që në Kotorr në sh. IX të ketë pasur një organizatë detare esnafe me karakter ushtarak. Megjithatë, dokumenti më i vjetër që flet për këtë organizatë daton nga shekulli XII. Dokumenti përmend dy anije ku mirëmbajtja, armatimi dhe furnizimi i ekuipazhit nuk mund të imagjinohet pa ekzistencën e një organizate detare. Në përputhje me rrethanat, mund të konkludojmë se, sipas traditës fillimet e flotës detare mund të gjurmohen që në shekullin e IX dhe nëse bazohemi në pretendimet me burime historike, atëherë është shekulli XII. Nga pikëpamja shkencore, dokumenti më i besueshëm që flet për flotën detare është Statuti i tij më i vjetër, i ruajtur nga v.1463. Shumica e historianëve pajtohen me supozimin që organizata kishte statute më të vjetra se kjo, por ato nuk janë ruajtur.

Sipas atij Statuti, emri i organizatës ishte “Vëllazëria Kotor e Shën Nikollës Detar” (Fraternitas Divi Nicolai marinariorum de Catharo). Gjatë sundimit venedikas, vëllazëria pat jo vetëm një rol ekonomik në lidhje me transportin dhe tregtinë, por edhe luftën në ruajtjen e sigurisë në gji, luftën kundër piratëve dhe piratëve në Adriatik, pjesëmarrjen në operacionet ushtarake në luftërat e shumta të udhëhequra nga Venedikasit gjatë shekullit XVI, XVII dhe XVIII.

Me rënien e Republikës së Venedikut dhe ardhjen e Austrisë në këto zona, puna e Vëllazërisë u ndalua. Gjatë sundimit të shkurtër rus (1806-1807), flota detare vazhdoi lirisht aktivitetet e saja dhe mori pjesë në disa veprime ushtarake nën komandën ruse. Për at arsye administrata franceze në Bokë (1807-1813) ndaloi punën e flotës detare. Gjatë administratës së përbashkët të shkurtë të Malit të Zi dhe Bokës (1813-1814) flota detare e Kotorrit u rivendos, ku funksionet e saja u ndaluan nën sundimin austriak deri në v.1833. Që nga ajo kohë, organizata punon me emrin e flotës detare të Bokës dhe ka ruajtur klasat e saja por jo funksionet ushtarake. Gjatë ngjarjeve revolucionare të v.1848, marina u shfuqizua përsëri deri në v.1859, kur u formua një organizatë përkujtimore “Grupi i fiseve të marinerëve të Bokës”. Si institucion përkujtimor, ajo vazhdoi punën e saj në Mbretërinë e Jugosllavisë, në Jugosllavinë socialiste, deri më sot.




Grupi i dytë: Statuti i flotës detare të Bokës –tiparët e organizatës ekonomike, shoqërore, humanitare.

STATUTI I VITIT 1463

Statuti më i vjetër i ruajtur i flotës detare të Bokës daton nga viti 1463. Bëhet fjalë për një dorëshkrim jashtëzakonisht të vlefshëm në 72 fletë pergamene. Prej saj mësojmë për jetën ekonomike dhe shoqërore të Kotorrit. Aspekti shoqëror është i rëndësishëm sepse flota detare zgjodhi anëtarët e saj midis marinerëve, duke përjashtuar fisin. Meqenëse bëhet fjalë për organizatën që zhvilloi detiarinë si degë të forte ekonomike të qytetit, ajo gjithashtu kushtëzoi ndryshimet shoqërore në Kotorin mesjetar - forcimin e shtetësisë dhe rënien e fisnikërisë, zhvillimin e vendbanimeve të vogla bregdetare në komuna të pavarura si Prcanj, Dobrota dhe Perast.



Stema e flotës detare të Bokës



Statuti i flotës detare të Bokës

Organizimi i brendshëm i Vëllazërisë është i rregulluar me statut. Ajo drejtohej nga një gastald, pastaj dy sindikata, tre prokurorë, kujdestarë dhe një kapelan. Është e rëndësishme të theksohen ato tipare që i dhanë një rëndësi të veçantë flotës detare të Kotorrit, dhe kjo është bashkimi i funksionit të gastald, një lloj udhëheqësi profesional në flotë, me funksionin e admiralit të portit gjatë administratës së Venedikut. Kjo do të thotë që çeta e marinarëve të armatosur komandohej nga një person i cili ishte në krye të organizatës profesionale.

Kjo i dha vëllazërisë një rol të rëndësishëm ushtarak.

Statuti përcakton detyrat e organizatës: mbajtja dhe azhurimi i vazhdueshëm i listës së marinarëve të gatshëm për aktivitete ushtarake dhe tregtare, roli i një lloj policie detare në Boken (Gjirin) e Kotorrit, pjesëmarrja në veprimet e luftës detare të Republikës së Venedikut nëse është e nevojshme, marrja e pushtetit në qytet gjatë tre ditëve të kremtimit të shenjtit mbrojtës të qytetit dhe pjesëmarrja në organizimin dhe mbrojtjen e festivalit, pjesëmarrja në shërbimin mjekësor, me kontrollin e anijeve që vijnë nga zonat e infektuara dhe organizimin e shërbimit postar detar.

Për këto arsye, admiralitë gëzonte një reputacion të madh në qytet, ai barazohej me zyrtarët e qytetit dhe nganjëherë shkonte si përfaqësues i qytetit dhe para Senatit në Venedik.

Në periudhën e mëparshme, nxënësit e popullsisë rome dhe egjiptiane u regjistruan në shkollat e mesme ku klasat zhvilloheshin në gjuhën malazeze dhe në gjuhë të tjera në përdorim zyrtar me parimet e veprimt pohues. Me të njëjtin parim, falë përpjekjeve të institucioneve kompetente dhe sektorit civil, numri i anëtarëve të popullsisë rome dhe egjiptiane të regjistruar në institucionet e arsimit të lartë ndjeshëm është rritur...

▾ Bashkangjtitja nr. 6 (grupi IV)

STIGMATIZIMI DHE DISKRIMINIMI NDAJ FËMIVË QË I PËRKASIN GRUPEVE TË NDIHMËS SOCIALE⁴

Përfashtimi social i fëmijëve romë dhe egjiptianë rrezikon seriozisht aksesin e tyre në arsim, duke i bërë këta fëmijë të padukshëm në sistem dhe duke e rritur përqindjen e jo regjistrimit në shkollën e mesme. Studimet e kryera në vendet e Evropës Juglindore tregojnë një ndryshim të dukshëm në nivelet e shkollimit midis Romëve dhe Egjiptianëve dhe fëmijëve nga popullsia e shumicë, veçanërisht në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Mal të Zi, të shkaktuara më së shumti nga përfashtimi social.

Në gjithë Evropën Juglindore, qeveritë e pranojnë me ndarjen e fëmijëve romë dhe egjiptianë kontribuon në mosregjistrimin dhe largimin e hershëm të shkollës, e cila është e lidhur ngushtë me stigmën dhe diskriminimin. Jobarazimi është faktor rreziku për arsimimin e fëmijëve të popullsisë rome dhe egjiptiane, dhe në sistemin arsimor manifestohet në tre forma: : 1) ndarja e shkollave - romët dhe egjiptianët kryesisht ndjekin shkollën në të cilën nxënësit romë dhe egjiptianë përbëjnë shumicën dhe të cilat ndodhen shpesh afër vendbanimeve rome; 2) ndarja brenda shkollave - në rastin e shkollave heterogjene, nxënësit romë dhe egjiptianë shpesh ndahen nga nxënësit e tjerë duke i vendosur në klasa speciale; 3) ndarja në shkolla speciale - fëmijët romë dhe egjiptianë dërgohen në mënyrë disproporcionale në shkollat speciale.

Në Mal të Zi, ndarja në arsim është ngushtë e lidhur me ndarjen e banimit. Popullsia rome dhe egjiptiane në shumicën e rasteve jetojnë në vendbanime të izoluara, shpesh në kampe refugjatësh, ku aksesin në arsimim është mjaft i kufizuar. Ndër lokalitetet ku është vërejtur ndarja në arsim është komuna e Beranës dhe Podgoricës...

3 STRATEGIJA ZA SOCIJALNU INKLUZIJU ROMA I EGIPĆANA U CRNOJ GORI 2016 – 2020, Ministarstvo za ljudska i manjinska prava, Podgorica 2016.

4 STUDIJA O PREPREKAMA U OBRAZOVANJU U CRNOJ GORI: Romska i egipćanska djeca, UNICEF CRNA GORA, Podgorica 2013, str. 38-39

Detyrat e shtëpisë⁵

- Arsyet kryesore të braktisjes së shkollës të popullsisë RE;
- Me çfarë sfidash përballohet popullsia RE në vendin tonë;
- Shembuj pozitiv (afirmativ);
- Anëtarët e popullatës RE në Mal të Zi.

Teksti në bashkangjitje mund të përdoret si pikë fillestare, bazuar në të cilën studentët bëjnë prezantim në PPT. Mësuesi inkurajon nxënësit të përdorin aftësitë e tyre në bërjen e detyrave. Nxënësit e talentuar në stem të shkencë mund të bëjnë përpunim statistik dhe paraqitjen grafike, nxënësit e talentuar në art dhe gjuhë mund të krijojnë një përfaqësim artistik të temave e dhëna dhe të ngjashme.

KASTRIDI, DJALI QË KUJDESET PËR FAMILJEN E TIJ DHE NDIHMON BABAIT TË TIJ NË MBLEDHJEN E USHQIMIT

Kastridi është 14 vjeç. Ai jeton në Konik (Podgoricë) në një shtëpi kartoni të rrënuar me prindërit dhe pesë vëllezërit e motrat e tij. Ata janë strehuar atje që kur familja u zhvendos nga Kosova. Përveç hapësirës së ngushtë, higjiena është një problem në shtëpinë e tyre. Gjegjësisht, ata nuk kanë energji elektrike dhe ujë, as pajisje sanitare.

Kastridi është fëmija më i madh në familje. Ai ndoqi shkollën fillore deri në klasën e VI-të. Më pas e la shkollën. Ai flet malazezisht mjaft dobët, por gjatë intervistës ai përktheu bisedën për nënën e tij, pasi ajo di vetëm shqip. Sipas pohimeve të tij dhe pretendimeve të nënës së tij në shkollë, ai arriti mirë dhe dinte të shkruante dhe të lexonte. Prapë se prapë ai përsëriti klasën e 6-të. Ai mbaroi katër klasat e para në shkollën *Bozidar Vukoviç* në Konik dhe pas kalimit në klasat lëndore, ai filloi të ndiqte shkollën e tij afër shtëpisë. Ndërtesa kryesore e shkollës është e vendosur në afërsi të vendbanimit dhe mund të arrihet në këmbë për rreth 15 minuta, kështu që transporti nuk është pengesë. Kalimi në klasën e pestë, përsëri sipas familjes, nuk paraqiste pengesë në shkollim, as në aspektin arsimor dhe as në atë shoqëror. Nuk kishte probleme në të mësuarit ose në

marrëdhëniet me mësuesit dhe shokët e klasës.

Arsyeja kryesore e braktisjes së shkollës, sipas prindërve dhe djalit janë kushte e këqija materiale dhe mohojnë rolin e tyre në këtë proces. Shkollimi u ndërpre në momentin kur motra e vogël (fëmija i dytë me radhë) u referua për trajtim spitalor për shkak të sëmundjes. Nëna pastaj kaloi shumë kohë me të, babai mblidhte ushqim në kontejnerë, kështu që Kastridi duhej të kujdesej për vëllezërit dhe motrat e tij të vegjël. Në të njëjtën kohë, kur nëna e tij ishte në shtëpi, ai e ndihmonte babanë e tij të kërkonte ushqim dhe të mblidhte lëndë të para dytësore.

Në rastin e Kastridit, ashtu si me fëmijët e tjerë nga fqinjësia, shkolla, përmes një ndërmjetësi rom, u dërgoi një ftesë prindërve për të folur për mos ndjekjen e klasave. Prindërit, si shumica e fqinjëve të tyre, i injoruan këto thirrje. Pas kësaj, shkolla nuk reagoi. Dhe këtu u ndal sistemi. Asnjë institucion tjetër nuk është njoftuar për këtë rast.

Faktorët e mjedisit dhe situata e dobët financiare ndikojnë shumë në këtë rast. Vajza është ende në kurim, familja po jeton shumë vështirë.

⁵ Tekst je preuzet iz: *STUDIJA O PREPREKAMA U OBRAZOVANJU U CRNOJ GORI: Romska i egipćanska djeca*, UNICEF CRNA GORA, Podgorica 2013.



Igor Radulović

Historia e Hebrenjve në tokën e Malit të Zi

MËSUESI	Prof. Igor Radulović		
NJËSIA MËSIMORE	HISTORIA E HEBRENJVE NË TOKËN E MALIT TË ZI		
UDHËZUES I ORËS	NJË ORË E MËSIMIT (45 min.)		
LËNDA MËSIMORE	Historia	KLASA	III IV
TEMA E ORËS	Epoka e re Mali i Zi nga v. 1698 deri në v. 1851 Mali i Zi në luftën e dytë botërore		
QËLLIMET	Kuptimi kritik i ngjarjeve nga historia e popullit hebrej në Mal të Zi. Zhvillimi i empatisë ndaj popujve dhe komuniteteve me pakicë.		
REZULTATET E MËSIMIT	<i>Vlerësojnë pozitivisht trashëgimitë kulturore të popullit hebrej në Mal të Zi.</i> <i>Të zhvillojnë qëndrimet e tyre mbi rolin e komunitetit hebre në vendin tonë.</i> <i>Të analizojnë burimet historike dhe nxjerrin përfundimin.</i> <i>Të krahasojnë pozicionin e popullit hebre në Mal të Zi me pozicionin e hebrenjve në shtetet e tjera.</i> <i>Të veçojnë dhe përcaktojnë ngjarjet më të rëndësishme për historinë e popullit hebre në Mal të Zi.</i>		
FORMA DHE METODA E PUNËS NË ORË	Individual, punë në grupe, punë në telst, monolog, dialog, mësim përmes zgjedhjes së problemit		
Mjetet mësimore	Libri shkollor, burimet historike, projektori		
LITERATURA	Udžbenik za III razred Gimnazije Udžbenik za IV razred Gimnazije Almanah Jevrejske zajednice Crne Gore, br. 1, Godina 1, Podgorica 2014. Almanah Jevrejske zajednice Crne Gore, br. 9-10; Podgorica 2020.		
Web link	http://jevrejskadigitalnabiblioteka.rs http://www.jevzajcg.me		
Korrelacioni	Arti figurativ, Gjeografia, Historia e religjionit		

Përmbajtja (rrjedha) e punës

Përgatitja e nxënësit - hyrje në temë ose njësi



<p>RRJEDHA E ORËS:</p>	<p>Nxënësve u jepet një sërë pyetjesh dhe termash për t'u përgjigjur në mënyrë që të njohohen më shumë me temën (bashkangjitja nr.1)</p>
<p>AKTIVITETI I HYRJES</p>	<p>Së bashku pas përfundimit të aktivitetit të parë, nxënësit ndahen në katër grupe.</p>
<p>AKTIVITETI KRYESORË</p>	<p>Nxënësit lexojnë dhe analizojnë burimet historike, duke ndjekur pyetje dhe udhëzime në lidhje me detyrën e dhënë</p> <p>Grupi I fitoi burimet historike VARRET HEBREJE NË DUKËL (bashkangjitja nr.3)</p> <p>Grupi II fitoi burimet historike BASHKANGJITJE E SHKURTËR PËR HISTORINË E VARRET HEBREJE NË KOTORR (bashkangjitja nr.4)</p> <p>Grupi III fitoi burimet historike SABATAJ CEVI (bashkangjitja nr. 5)</p> <p>Grupi IV fitoi burimet historike FATI I DISA HEBREJVE NË PLEVLA NË LUFTEN E II BOTËRORE – VIDA ALKALAJ (bashkangjitja nr. 6)</p>
<p>AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR</p>	<p>Nxënësit vlerësojnë bashkërisht trashëgiminë historike dhe kulturore të popullit hebre në Mal të Zi nga koha e lashtë deri në ditët e sotme.</p> <p>Së bashku bëjnë një kronologji të ngjarjeve të përshkuara në burimet historike që kanë analizuar.</p>
<p>Aktivitetet e nxënësit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit prezantojnë njohuritë e tyre më parë në lidhje me historinë dhe kulturën e popullit hebre; • Nxënësit u përgjigjen pyetjeve dhe detyrave (bashkangjitja nr.1); • Nxënësit ndahen në katër grupe dhe sipas udhëzimeve japin përgjigje për pyetjet dhe detyrat (bashkangjitja nr.2); • Nxënësit shpjegojnë mendimet dhe qëndrimet e tyre, e shikojnë në mënyrë kritike pozicionin e hebrenjve në Mal të Zi; • Nxënësit bëjnë kronologjinë e ngjarjeve, në të cilën ata lartësojnë jetën e hebrenjve në këtë rajon nga kohërat e lashta deri në ditët e sotme.



Bashkangjtitja nr. 1:

Lidhni termat me përkufizimet e tyre:

- *Diaspora hebreje*
- *Sefardi*
- *Sionizmi*
- *Ashkenazi*

- *Hebrenjtë u dëbuan nga Spanja në 1492 dhe nga Portugalia në 1497. Termi rrjedh nga fjala hebraike që do të thotë Spanjë;*
- *një pjesë e popullit hebre gjuhën e të folurit e kanë jidish ose gjermanisht;*
- *persekutimi, shpërndarja, shpërngulja e hebrenjve nëpër botë*
- *lëvizja nacional-politike hebraike për krijimin e një shteti të pavarur sovran.*

Pyetjet:

- *Sa terma do ishit në gjendje ti definoni në ushtrimin e parë pa përgjigjet e ofruara?*
- *Merrni parasysh pse ka më shumë hebrenj në shtetet e regjionit sesa në Mal të Zi?*
- *A jeni njohur me ndonjë traditë të popullit hebre? A keni dëgjuar për ndonjë festë fetare që e festojnë hebrenjtë? A keni pasur ndonjëherë mundësi të vizitoni sinagogën?*
- *A dini më pak a më shumë për Judaizmin në krahasim me fetë e tjera monoteiste? Pse mendoni se është ashtu?*

Bashkangjtitja nr. 2:

Detyrë për grupin I:

Bazuar në burimin historik, nxënësit përpiqen të rindërtojnë jetën e (dy) hebrenjve në rajonin e Duklës gjatë Perandorisë Romake, të udhëhequr nga pyetjet në vazhdim:

- *Çfarë aktiviteti mund të kryenin në Dukla?*
- *Çfarë mund të na tregojë dekorimi i brendshëm i varrit për statusin e tyre shoqëror?*
- *Për cilat arsye ata vendosën të qëndronin dhe të jetonin në Dukla, pavarësisht nga fakti se ata ishin përfaqësuesit e vetëm të popullit të tyre?*

Detyrë për grupin II:

Bazuar në burimin historik, nxënësit vlerësojnë pozicionin e komunitetit hebre në Bokën (Gjirin) e Kotorit, të udhëhequr nga pyetjet në vazhdim:

- *Çfarë ndikimi ka ardhja e monarkisë Habsburge në zonën e Bokës (Gjirit) së Kotorit në zhvillimin e komunitetit hebreje?*
- *Pse mendoni se numri i hebrenjve në Kotor u rrit vazhdimisht në shekullin e XIX?*
- *Çfarë aktivitetesh mund të kryenin në atë rajon?*

Detyrë për grupin III:

Bazuar në burimin historik, nxënësit vlerësojnë jetën dhe veprën e Shabbat Cevi, të udhëhequr nga pyetjet në vazhdim:

- Bazuar në çka mund të konkludojmë se Sulltani e vlerësonte shumë personalitetin e Sabatai Cevi?
- Pse sulltani vendosi ta internojë Cevin në Ulqin?
- Çfarë mund të mësojmë për atë qytet nga periudha kur Cevi jetonte në të?

Detyrë për grupin IV:

Bazuar në një burim historik, studentët vlerësojnë jetën e hebrenjve në Plevla gjatë Luftës së Dytë Botërore, të udhëhequr nga pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë dimë për jetën e profesoreshes Alkalaj para shpërthimit të Luftës së Dytë Botërore?
- Si e ndryshoi pozicionin e saj në shoqëri Lufta e Dytë Botërore?
- Çfarë na tregon fati i profesoreshes Alkalaj për fatin e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore?

▣ Bashkangjittja nr. 3 (grupi I)**VARREZET HEBREJE NË DUKËL¹**

Gjatë gërmimit sistematik të nekropolit lindor të Dukles, në vitin 1960 u zbulua një varr mes varreve paganë, i cili meriton vëmendje të veçantë për shkak të dekorimit të brendshëm të jashtëzakonshëm. Ky varr ndodhet në pjesë juglindore të nekropolit, dmth. në brezin e saj periferik ku varret rradhohen dhe humbin papritur. Ashtu si varret e tjerë në nekropolin lindor, edhe ky varr (nr i varrit 281) është varrosur në shtresë sedimentesh aluviale me zall...

... Varri është i mbyllur në ana jugore nga një gurë i madh dhe tulla drejtkëndëshe e zbukuar me brazda të vizatuara në mënyrë diagonale. Dy të vdekur janë të varrosur me kokë në anën veriore. Skeleti i parë i zhvarrosur, vetëm pjesërisht i ruajtur, shtrihet përgjatë murit lindor, ndërsa i varrosuri më vonë është vendosur pothuajse në qendër të varrit. Për shkak të mos ruajtjes të eshtrave, veçanërisht të pjesës pelvike, nuk është e mundur të përcaktohet gjinia e saktë. Megjithëse është e sigurt, se të rriturit janë varrosur këtu....

Duket se varri nr. 281 përfaqëson varrin e një familje hebreje që emigroi në Dukël gjatë kohës së tetrarkisë ose Kostandinit të Madh. Skeletet e vetëm dy personave të vdekur u gjetën në varr, mesiguri të burrit dhe gruas, që do të thotë se pasardhësit mund të jenë larguar nga Dukla. Meqenëse nuk kishte më hebrenj në Dukël, dhe nuk kishte ndonjë varrezë të veçantë hebreje, ky varr familjar gjithashtu mbeti si nekropol pagan. Për ta ndarë qartë nga varret e paganëve, në të u bë zbukurim karakteristik mbi kokat e të ndjerëve që jetuan dhe u varrosën nën kujdesin e besimit të tyre.

¹ Marrur nga: <http://jevrejskadigitalnabiblioteka.rs/bitstream/handle/123456789/533/jal0604srejevicjevrejska.pdf?sequence=1&isAllowed=y>; Aksesohe: 08.01.2021.

▣ Bashkangjitja nr. 4. (grupi II)

BASHKANGJITJE E SHKURTËR PËR HISTORINË E VARRET HEBREJE NË KOTORR²

Pavarësia që Republika Venedikase humbi me Paqen e Campofornio në 1797. më në fund u definua nga vendimet e Kongresit të Vjenës (1 shtator 1814 deri më 9 qershor 1815), sipas të cilit vendet e saj, përfshirë bregdetin malazez nga Budva deri Herceg Novi, u bënë pjesë e Monarkisë së Habsburgut dhe brenda kufijve të saj deri në fund të vitit 1918 domethënë fundi i luftës së parë botërore. Ndryshimet politike dhe shoqërore që ndodhën në Bokë dhe Kotorr me ardhjen e Austrisë ndikuan në ndryshimin urban në këtë rajon. Zakoni i varrosjes në kisha dhe varreza në rrethin e tyre të ngushtë u ndalua në v.1818 me vendim të qeverisë së Monarkisë Habsburge, e cila vlente për të gjithë territorin e Perandorisë. Ky vendim vlente edhe për qytetin e Kotorrit. Ky vendim u zbatua (tashmë) që nga viti 1820, ku peshkopi i atëhershëm caktoi një ngastër të madhe toke në Shkalarë për qëllimet e varrimit dhe varrezave. Gjysma e ngastrës u dha kishës Ortodokse në kushte të caktuara. Me kalimin e kohës, lindi nevoja që në këtë vend të përcaktohet një pjesë për varrimin e anëtarëve të besimit të Moisiut. Me propozim që t'u jepej një ngastër toke, Peshkopi i Kotorrit la një vend të caktuar nga pjesa ku ishin varrosur katolikët dhe ia dorëzoi Komunitetit Hebre në Kotorr, që dëshmon fragmenti nga çertifikata e Regjistrimit të Tokës nga Komuna Kadastrale e Shkalarëve nga v.1884, ku tregon se kjo ngastër toke është pronë e këtij komuniteti.

Me ardhjen e administratës Austriake, nga regjistri i qytetit të Kotorrit, mund të ndjekim numrin e hebrenjve që ishin regjistruar si banorë. Kështu, sipas regjistrimit të vitit 1829. në Kotorr, dy hebrenj regjistruan vendbanimin e tyre dhe në 1834 nga gjithsej 2003 persona të numëruar në Kotorr (Qyteti i Vjetër), 6 prej tyre ishin të fesë hebraike. Të dhënat e regjistrimit në lidhje me zonën e Qytetit të Vjetër për v.1843 tregojnë se 12 hebrenj jetonin brenda mureve të Kotorrit të vjetër, 9 burra dhe 3 gra. Në regjistrimin tjetër, dy vjet më vonë, brenda mureve të Kotorrit jetonin 15 anëtarë të besimit të Moisiut, nga të cilët 8 ishin burra dhe 9 gra.

Që nga viti 1846, nuk kemi të dhëna për numrin e hebrenjve në Kotorr, por fakti se në v.1884 ekzistonte një komunitet hebre i regjistruar, pa dilemë flet për numrin dhe organizimin e tyre të konsiderueshëm në këtë qytet antik.

▣ Bashkangjitja nrr. 5. (grupi III)

SABATAJ CEVI³

Një nga njerëzit më të njohur të kohës së tij dhe sigurisht një nga njerëzit që la një gjurmë të pashlyeshme në muret antike të Kalasë të Ulqinit, është pa dyshim Sabataj Cevi. Njeriu që shënoi një pjesë të trashëgimisë kulturore botërore, i cili, me pamjen dhe mësimin e tij, dha kontribut të madh në histori jo vetëm në vendin tonë, por gjithashtu mund të thuhet lirisht në nivel global. Duke deklaruar veten "Mesia" i ri, ky njeri me inteligjencë mbi mesatare dhe arsim të gjerë la një gjurmë të thellë që ende zgjon interesin e jo vetëm shkencëtarëve dhe teologëve, por edhe njerëzve të thjeshtë, të cilët përpiqen të hulumtojnë gjitha segmentet e punës së tij në perandorinë Osmane...

...I lindur në Izmir në vitin 1626 në një nga kryeqytetet e Perandorisë Osmane. Në popullsinë e madhe të hebrenjve në Izmir, Sabataj Cevi kërkoi lirinë, ishte një teolog i lirisë dhe e kuptoi se kjo ishte gjëja më e madhe që një njeri mund të kishte në besim. Në predikimet e tij, veçanërisht mbi Talmudin, librin e shenjtë të hebrenjve, ai ishte aq sugjestionues sa që të gjithë menduan se ai ishte njeri i

2 Đorđe Raičević, O groblju i jevrejima u Kotoru, Almanah Jevrejske zajednice Crne Gore, br. 1, Godina 1, Podgorica 2014.

3 Marrur nga: <http://www.jevzajcg.me/index.php/jevreji-u-crnoj-gori/zanimljivosti/133-ismet-karamanaga-ulcinj-sabataj-cevi>; Aksesohet: 10.01.2020.

ardhmes, personi i cili duhet të vinte dhe ta çonte popullin hebre në atdheun e tyre të mëparshëm. Ishte i lindur të ishte udhëheqës. Në vitet e dyzeta të tij, i motivuar nga gjeniu i tij dhe ndjenjës së brendshme të pazakontë, ai e shpall veten “Mesia” i ri për të gjitha kombet, për gjithë botën në Perandorinë Osmane... Duke e shpallur veten “Mesia”, Cevi i dha shpresë masës, shpresë për çlirim nga skllavëria, shpresë për lirinë fetare....

... Sulltani më pas i tha Cevit se ai duhet të ndryshonte fenë e tij, sepse kur ai kishte guxim t'i kërkonte sundimtarit të botës të ndryshonte fenë e tij, ai tani e kërkoj atë prej tij. Dhe kështu Sabataj Cevi merr emër të ri Mehmet Efendija dhe duke vënë vetes turbanin, shkoi në mërgim në Ulqinin e largët.

... Sulltani ja fali jetën mesiut të vetëshpallur por ndjekësit e tij nuk pushuan së mbledhuri ku nuk mund të besonin se ai nuk ishte mesia. Për të shmangur mbledhjet dhe trazirat, vezirët këshilluan Sulltanin ta internojnë Sabataj Cevin në qytetin më të largët të Perandorisë Osmane, në Ulqin, në kala. Pavarësisht nga fakti që ai ishte i internuar, Sulltani i dha Cevit titullin Dizdar ose kujdestar i kalasë, ku ai dhe shoqëruesit e tij erdhën në qytetin antik të Ulqinit, ku do të kalonte dhjetë vitet e fundit të jetës së tij në katin e tretë të kullës Ballshiqë. Princi më i famshëm nga familja e Ballshiqëve, Gjergj Ballsha, vdiq në atë kullë dhe sot ajo kullë mban emrin e tij, kulla e Ballshiqëve. Në atë kullë, e cila sot gjendet me krenari në pjesën më të lartë të Kalasë, Sabataj Cevi gjen paqe, reformon Talmudin dhe lexon literaturë tjetër teologjike që kishte. Ai fliste gjashtë gjuhë dhe ishte njeri me inteligjencë mbi mesatare dhe arsim të lartë. Flitët që ai u largua nga qyteti vetëm dy herë, një herë shkoi për të vizituar manastirin Benedikti Rotaci pranë Tivarit, ndërsa herën e dytë ai shkoi në qytetin e vjetër të Shasit. Ai gjithashtu shkroi disa letra nga Ulqini, veçanërisht atë drejtuar njëres nga tre gratë që kishte, Sarës Elahun, të cilën e la në Izmir. Në disa fragmente të tjera përmend shqiptarët e Ulqinit, flet për tërmetet e tmerrshme që goditën këtë qytet dhe për tridhjetë vajza që u hodhën nga muret e Kalasë për të mos rënë në skllavëri. Gjithashtu ka përshtatuar një lloj të veçantë bari që rritet në muret e qytetit. Ai ishte njeri i fjalës, prandaj ka shkruar pak.

... Sot, në katin e tretë të kullës së Ballshiqëve, ekziston ylli i Davidit i gdhendur në mermer të bardhë, i cili konfirmon tezën se ai mbeti një hebre thellë në shpirtin e tij.

Bashkangjittja nr. 6 (grup IV)

FATI I DISA HEBREJVE NË PLEVLA NË LUFTEN E II BOTËRORE – VIDA ALKALAJ⁴

Vida Alkalaj erdhi në Plevla para luftës së dytë botërore si profesoreshë e diplomuar e frëngjishtes, e cila dha mësim në gjimnazin Plevla nga klasa I deri në klasën e VIII. Kështu zonjusha Alkalaj mësonte frëngjishten për të gjitha klasat.

Si profesoreshë, me një pamje shumë të këndshme dhe të bukur e të drejtpërdrejtë, ajo fitoi afekcionin jo vetëm të pjesëmarrësve dhe kolegëve, por edhe të njerëzve të tjerë me të cilët rrinte jashtë gjimnazit.

Profesoresha Alkalaj jetonte tek një familje e respektuar Popoviq nga Plevla, shtëpia e së cilës ndodhej në qytet. Djemtë e Plevlës shpesh nën dritare në mbrëmje të shoqëruar nga një kitarë i këndonin lehtë profesoreshës simpatike. Ishin serenata, të cilat ndoshta i përshtateshin zonjushës Alkalaj. Në atë kohë, njerëzit jetonin të lumtur dhe të kënaqur.

Lufta që pasoi ndryshoi jetën e banorëve të Plevlës, dhe veçanërisht të Vida Alkalaj, kundër popullit filloi një gjenocid i paparë. Plevla ra nën zonën e okupimit Italian. Kjo ishte rëndësishme sepse besohej se italianët nuk i persekutonin hebrenjtë ashtu si gjermanët dhe ustashët. Përveç kësaj, profesoresha pësoi shqetësim. Humbi punën e saj. Në vend të frëngjishtes, italishtja u mësonte në Gjimnaz. Vida Alkalaj mbeti ekonomikisht keqë. Sidoqoftë, u gjendën shumë miq që profesoresha kishte në Plevla. Aq sa kishin u ndante dhe kishte ende mjaft.

⁴ SUDBINE NEKOLIKO JEVREJA U PLJEVLJIMA U II SVJETSKOM RATU, Almanah Jevrejske zajednice br. 9-10, Podgorica 2020.





Në fillim të kryengritjes në Mal të Zi, sidomos pas betejës së Pljevljes më 1 dhjetor 1941, erdhen ditë të vështira për të gjithë, duke përfshirë edhe profesoreshen Alkalaj. Një tjetër rrezik pasoi në pranverën e vitit 1942, kur togeri gjerman KURT VALDHEIM erdhi në Plevla në mision të veçantë, me një shoqërim dhe stacion special radio. Në atë kohë, divizioni italian PUSTERIA ishte në Plevla me 2000 ushtarë. Ardhja e K. Waldheim Valdheim përfaqsoi rrezik të madh për të gjithë banorët. Italianët bënë orën e policisë, arrestime dhe vrasje. Kështu, më 4 maj 1942, në Senjak 34 pengj patriotë u qëlluan dhe u vran.

Të gjitha këto profesoresha Vida Alkalaj i përjetoi me të njohurit dhe miqtë e saj. Nervat e lëshuan dhe një mëngjes u gjet e vdekur në shtrat në dhomën e saj. Ishte e re, e shëndetshme, asnjëherë e sëmurë. Është e mundshme që në gjithë atë makth dhe pasiguri, bëri vetëvrasje.

Vdekja e profesoreshës së dashur Vida Alkalaj u prit me hidhërim në Plevla. Nxënësit, kolegët profesorë, miqtë, të gjithë ata që e deshën, e respektuan dhe e vlerësuan, e shoqëruan atë në jetën e përjetshme. E shoqëruar nga ata që i këndonin me një kitarë në mbrëmje, poshtë dritares. Djemtë e Plevlës qanin tani.

Në varrezat e qytetit, në anën e djathtë, në fund të gardhit, mbetjet mortore të Vida Alkalaj edhe sot pushojnë aty, me gur varri modest dhe yllin e Davidit.

Mali i Zi-takim multietnicitetesh

MËSUESI	Vesna Kovaçeviq , Zvezdana Lakiq		
NJËSIA MËSIMORE	Mali i Zi-takim multietnicitetesh		
UDHËZUES I ORËS	Një orë e mësimi (45min)		
LËNDA MËSIMORE	Historia	KLASA	III (shkolla e mesme)
TEMA E ORËS	<i>Mali i Zi-takim multietnicitetesh</i>		
QËLLIMET	<p>Edukativ</p> <p>Përvetësojnë njohuri për historinë e Malit të Zi nga fundi i shekullit XVII, njoftohen me krijuesit më të rëndësishëm të kulturës, kuptojnë ndryshimet socio-ekonomike, si dhe pasojat që kanë ndikuar në dallimin e pasurive të pakicave në Mal të Zi.</p> <p>Funkcional</p> <p>Kuptojnë rëndësinë dhe ndikimin e pakicave kulturore në Mal të Zi në të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen, vlerësojnë rëndësinë e ndryshimeve të shkaktuara nga lufta për emancipim, theksojnë arritjet pozitive dhe negative</p> <p>Edukativ</p> <p>Të zhvillojnë vetëdijen e nxënësve për rëndësinë e bashkëjetesës së pakicave në Mal të Zi në botë moderne, aftësinë për të shprehur mendimet dhe konkluzimet e tyre, vlerësimin e saktë të arritjeve pozitive dhe negative të pasurisë së diversitetit</p>		
REZULTATET E MËSIMIT	<p>Nxënësit do të ken mundësi të;</p> <ul style="list-style-type: none"> -të përshkruajnë historinë e Malit të Zi prej v.1697; -të shpjegojnë rolin dhe pozitën e grave në shoqërinë malazeze; -të krahasojnë bashkëjetesën e pakicave në Mal të Zi në atë periudhë; -të vlerësojnë zhvillimin e emancipimit të grave në të ardhmen; -të analizojnë jetën kulturore dhe fetare në Mal të Zi. 		
FORMA DHE METODA E PUNËS NË ORË	Individuale, pun në grupe, frontale		



Mjetet mësimore	<p>Metoda e prezantimit me goj, metoda e bisedës, puna në tekst, lojë, punë me shkrim e nxënësve, metoda e eksperimentit, barometri i humorit, synimi</p> <p>Film dokumentar, Power Point prezantimi: „Pasuria e dallimeve- historia e kulturës të pakicave në Mal të Zi“, harta gjeografike e botës, fletat për punë, fotografitë.</p> <p>Salla ose kabineti për ceremoni i pajisur me mjete për prezantime të videove</p>
LITERATURA	<p>1. Historia–libri shkollorë për vitin e tretë gjimnaz, autorët: Dragutin Papovic, Sait Šabotić, Adnan Prekić, Milan Šćekić</p> <p>2. Histori për shkollat e mesme profesionale autorët: : Lovćenka Radulović, Nikola Mršulja, Željko Drinčić, Zdravko Pejović</p> <p>3. Interneti</p> <p>4. Literatur shtesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Andrijašević Živko (2015): Libër shkollorë për historinë e Malit të Zi,I-IV, Podgoricë,Instituti për tekste dhe mjete mësimore - Ferijer, dr. Frederik: Mali i Zi, ditari i mjekut zviceran; CID, Podgoricë, 2007. - T. Ling, Historia e fesë Lindore dhe Perëndimore, Shoqata letrare Serbe , Beograd, 2003. - mr. Lenka Blehov „Čelebić“, „Jeta e grave në Kotor ne shekullin e XV“ - mr. Vesna Kovačević: „Gratë dhe kontributi i tyre në historiografinë e Malit të Zi në gjysmën e parë të shekullit XX“
Web link	
Korrelacioni	<p>Gjeografi (hapësirë), gjuhë dhe letërsi malazeze-serbe, boshnjake, kroate (poezi, prozë, fjalor ...)</p> <p>Arti figurativ (objekte sakrale), Art muzikor (folklor, melos origjinal)</p>

Struktura e orës së mësimi

Etapat e orës	Forma e punës	Metoda e punës	Kohëzgjatja
Pjesa hyrëse e orës	Individual, frontal, punim në grupe	metodë eksperimenti, metoda e bisedës, punë në tekst, lojë, puna e shkruar e nxënësit, metoda e përpunimit të temës	15 minuta
Pjesa kryesore e orës	Individual, frontal	metoda e prezantimit me gojë, metoda e bisedës, demonstrimi	20 minuta
Pjesa përfundimtare e orës	Punim në grupe, individual, frontal	metoda e bisedës, demonstrimi, puna e shkruar e nxënësve, barometri i disponimit	10 minuta

Përmbajtja (rrjedha) e punës

Përgatitja e nxënësit - Hyrje në temë ose njësi



Aktivitetet e nxënësit	Aktivitetet e mësuesit
PJESA HYRËSE E ORËS	
<p>Pjesa e parë hyrëse e orës:</p> <p>Nxënësit ndahen në tri grupe dhe percaktojnë udhëheqësin</p>	<p>Pjesa e parë hyrëse e orës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - I drejton nxënësit në rezultatin e orës - Informim për nxënësit që të ndahen në tre grupe, duke i lënë të zgjedhin, duke theksuar se grupet duhet të kenë nga pesë nxënës, si dhe udhëheqësin e grupit.
<p>Pjesa e dytë hyrëse e orës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgjigjen në orë: - Nxënësi lexon definicionin e eksperimentit; - I vendosin telefonat në katedër. 	<p>Pjesa e dytë hyrëse e orës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi njoftohet me konceptin e eksperimentit, duke bërë pyetje: <p>Pyetjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Cili term mund të përdoret për zavendësimin e fjalës eksperiment? 2. Çfarë do të thotë fjala eksperiment sipas mendimit tuaj? 3. Ku zhvillohen më së shumti eksperimentet? 4. A është eksperimenti, si metodë, i zbatueshëm në histori? <ul style="list-style-type: none"> - Grupeve u shpërndahet fleta me definicionin e eksperimentit - Nxënësve u kërkohet të aktivizojnë zilen në telefon dhe njoftimet (me zile të lartë) të pajisjeve (edhe atyre të mësuesve) dhe të gjithë i vendosin në katedër (qëllimi: përcaktimi i ndërhyrjes së celularit në orë)
<p>Pjesa e tretë hyrëse e orës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Numërojnë personalitetet - Gjatë asaj kohe, në dy tabela të larguara, në fletë, dy nxënës shkruajnë veç e veç personalitetet e historisë dhe të tjerët. Pas nxënësit të fundit, i cili tha termin, të tjerët, të cilët shkruan termat, kthejnë tabelat dhe vlerësojnë saktësinë e asaj që ishte e shkruar. 	<p>Pjesa e tretë hyrëse e orës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - udhëzon nxënësit që ora ka filluar, ku secili nxënës ka për thënë emrin e një personi të famshëm - historik, shkenctar, shkrimtar, secili nxënës do të përsërisë emrat e thënë nga nxënësit e tjerë; - I caktojnë dy nxënës të cilët do të shkruajnë veçmas në dy tabela të larguara, në fletë, figura historike dhe personalitete të tjera nga shkenca dhe arti i Malit të Zi; - Të parët filluan mësuesit; - Nxënësit që shkruan emrat në tabelat e larguara zbulojnë dhe percaktojnë nëse ata ndanë në mënyrë korrekte personalitete historike dhe të tjera nga shkenca dhe arti.

**Pjesa e katërt hyrëse e orës:**

- Shprehin mendimin e tyre
- Udhëheqësit e grupeve lexojnë definicionet, nxënësit e tjerë interpretojnë, diskutojnë dhe japin mendimin e tyre

Pjesa e katërt hyrëse e orës:

- Bëhën pyetjet:
 - Definicioni i termit „pakica“
 - Thuaj termin e kundër të fjalës „pakic“.
 - Cili është dallimi kur janë në pyetje popullsia e „shumicës“ dhe „pakicës“?
- Grupeve u shpëndahehet fleta me definicion, ku shpjegojnë se termi „pakicë“ ka shumë kuptime

PJESA KRYESORE E ORËS

- Shikojnë një video
- Në mënyrë aktive e ndëgjojnë leksionin dhe përcjellin prezantimin në Power Point
- Përgjigjen në pyetje të dhëna
- Komentojnë dhe shprehin mendimin e tyre

- Nxënësit shikojnë një dokumentar të shkurtër në lidhje me historinë kulturore të pakicave në Mal të Zi

(bashkangjitja 1)

- Deklarojnë mendimin e Trevor Linga

(bashkangjitja 2)

- Ofrojnë informacione të reja mbi multietnicitetin, multikonfesionalizmin
- Në hartën gjeografike të botës tregojnë Malin e Zi (më saktësisht kuptimi i parë i bashkëjetesës së pakicave në zonën e Duklës në kohën e Vojislavleviqëve)

(bashkangjitja 3)

- Ofrojnë informacione të reja mbi multietnicitetin, multikonfesionalizmin

- Citojnë Trevor Linga **(bashkangjitja 4)**

- Nëpërmjet pyetje inkuarojnë nxënësit të përfshihen në leksion dhe të shprehin mendimin e tyre

1. Shpjegoni termin „toleranca fetare“.
2. Si kanë luftuar njerëzit për të mbrojtur diversitetin?
3. Shpjegoni pozicionin e grave në të kaluarën?
4. Renditni aktivitetet themelore të grave, punët dominante.

- Lexojnë vargjet e Peter II Petroviq Njegosh dhe i drejtojnë nxënësit të konkludojnë nëse kishte ndryshime midis grave malazeze dhe grave të tjera (nga grupi i kombeve të pakicave) në Mal të Zi? **(bashkangjitja 5)**

- Shpjegojnë rëndësinë e pasurive të diverzitetit
- Shfaqin prezantimin në Power Point i cili shoqëron leksionin



PJESA PËRFUNDIMTARE E ORËS

-Në boshtin kohor të vizatuar në fletë, rreshtojnë fotografitë në mënyrë kronologjike, shkruajnë një koment
- Tabelat janë të larguara perderisa grupet punojnë
- Grupet i sjellin tabelat dhe krahasojnë përgjigjet, përcaktojnë saktësinë
- Ju përgjigjen pyetjeve
- Në posterin e përgatutur vlerësojnë orën me pikën ngjitesë

- Ndajnë detyrat nxënësve
- Nxënësve u ndahen tetë fotografi ose ilustrime (të cilat ishin të paraqitura në Power Point) me detyrë që ti rreshtojnë sipas boshtit kohor të vizatuar në fletë, ti ngjisin në mënyrë kronologjike dhe të japin koment poshtë ilustrimeve (bashkangjittja 1)
-Citojnë tekstin (bashkangjittja 2), pas kësaj nxënësit kanë për detyrë ta paraqesin mendimin e tyre se si mund të ruhet harmonia në Mal të Zi?
- Japin udhëzime se si ta vlerësojnë orën - vlerësimi

- Përgjigjen që as nuk e vuan re se po bie telefoni

-Pyesin se sa ka ndikuar zilja e telefonit gjatë orës

PAMJA E TABELËS

Tabela nuk është përdorur, PowerPoint përmban emrin e leksionit, tezat, fotografitë...

Detyrat e shtëpisë

Detyra 1:

- Të shikohet pozita e grave dhe si të luftohet kundër martesës së dhunshme e cila është akoma e pranishme në mjediset rurale, tek romët dhe popullsia myslimane, duke iu referuar pozitës së grave gjatë historisë
- Me diturinë e fituar nga historia, në tabelë shkruani vizionin e pasurisë së diversitetit të pakicave dhe rëndësinë e bashkëjetesës në Mal të Zi

Detyra 2:

- **Në celularin tuaj inçizoni një nga përbërjet e mëposhtme::**

Marshi turk - Mocart

Për Elizen - Betoven

Legjenda e Pavës dhe Ahmetit - lahuta popullore Stevan M.Popoviq

Bashkangjittja me përgatitje (skema, fletë pune)



▾ Për pjesen hyrëse të orës

Fleta e punës 1:

Eksperimenti, pamje, përshkrim, ose prova është procedurë analitike për studimin e mardhënieve shkakësore. Ai është një metodë e kërkimit shkencor në të cilën një fenomen ndryshohet qëllimisht dhe sistematikisht, në mënyrë që të provokojë, dhe më pas të vëzhgojë dhe matë një fenomen tjetër, ndërsa kushtet e tjera përkatëse kontrollohen ose izoloohen. Egzistojnë disa lloje të paraqitjeve, më i famshmi është ai laboratorik dhe paraqitja me shkas natyror.

Grupi i parë-fletë pune

Definicioni i pakicave:

term që i referohet një grupi, ose anëtarëve të një grupi, që është numerikisht më pak dominues në komunitet ose ka më pak fuqi dhe ndikim. Shpesh termi u referohet grupeve që kanë dallime në dallim me grupin dominues për sa i përket racës, fesë, etnisë ose identitetit politik dhe kulturor, i cili mund të jetë një faktor i fortë koheziv.

Grupi i dytë-fletë pune

Definicioni popujt pakicë janë:

komb pa shtet kombëtar.

Grupi i tretë- fletë pune

Definicioni i pakicave kombëtare është:

Grupë qytetarësh që dallojnë nga kombi nga shumica e popullsisë. Pakicat kombëtare ekzistojnë kryesisht në Evropën Lindore, ku pjesa e disa kombeve jetojnë në territorin e vendeve fqinjë. Pakicat kombëtare shpesh dallojnë nga pakicat etnike në atë që anëtarët e tyre marrin pjesë aktivisht në jetën e kombit të cilit i përkasin.

▾ Për pjesen kryesore të orës:

Film dokumentar: <https://www.youtube.com/watch?v=R3SulQmudEI&feature=youtu.be> (bashkangjithja 1)

“Thuhet se se, askush nuk është aq i vërbuar me fenë e vet, si ai që nuk e njeh asnjë tjetër”
(Trevor Ling) (bashkangjithja 2)

“Një studim i drejtë dhe i paanshëm i traditave fetare do të thotë të studiosh shkrimet e tyre historike me idetë që sjellin, llojet e personaliteteve që ata kanë krijuar dhe llojet e shoqërive që u janë bashkangjitur atyre.” * * (T.Ling, Historia e fesë Lindore dhe Perëndimore, shoqata letrare Serbe, Beograd, viti 2003, fq.6) (bashkangjithja 4)

↗ Harta gjeografike e botës
(bashkangjithja 3)



Ajo (Fatima) e ka shtatin selvi,
 porsi hyj i ka ata sy:
 ftyna e saj, mëngjes i kuqun,
 nën rrega i shndrit yll'i dritës:
 e ika gojën porsi pare,
 kallun buz't si dnandafilli,
 ndër t'cilat herë herë veton
 varg'i bardhë biseresh t'imtë:
 fyti i saj, fildishi vetë,
 duert e bardha, krahët e mjellmes:
 hyll'i dritës noton mbi lule
 dhe i shtyjnë rremat e argjantë.
 Lum shtrati ku do t'pushojtë



➤ Burimi: www.montenegrina.net

*Petar II Petroviq Njegosh (perkthimi Esad Mekuli dhe Zef Nekaj) (bashkangjitja 5)
 PowerPoint prezentimi*



➤ Burimi: www.hipmont.me



➤ Burimi: www.slobodnaevropa.org



➤ Burimi: www.wikipedia.org



➤ Burimi: www.wikipedia.org





➤ Burimi: www.magazinplus.eu



➤ Burimi: www.zumberacki-vikarijat.com



➤ Burimi: www.waytomonte.com

Bashkangjtitja 1

Përderisa ekziston një qëllim i njëjtë, i përbashkët, një yll udhëzues dhe një konstante e gjithëpranishme, asgjë nuk mund të prishë harmoninë, ku thotë:

„VUAJTJA ËSHTË TRAGJEDIA JONË E PËRBASHKËT, HEROIZMI ËSHTË THESARI YNË I PËRBASHKËT, DHE PËRDERISA ATA JANË TË JONAT, MALI I ZI DO TË JETË NJË.“ (bashkangjtitja 2)

Tabela për punimin e detyrave të shtëpisë:

Pasuria e diversitetit-hisotria kulturore e pakicave në Malin e Zi	E ardhmja për 5 vjet	E ardhmja për 10 vjet	E ardhmja për 20 vjet	E ardhmja për 40 vjet
Mali i Zi				
Europa				

Shënime, vëzhgime korigjuese

Eksperimenti ka treguar se nxënësit ishin shumë të interesuar për orë , sepse nuk kanë reaguuar në zërin e lartë të telefonit, kanë dhënë interesim të madh për orën e mësimit ku arritën të lidhin historinë me lëndët e tjera siç janë gjeografia, gjuha malazeze-serbe, boshnjake, kroate dhe letërsia, arti figurativ, arti i muzikës.

Për pjesen kryesore të orës kemi zgjedhur „metodat klasike“ – monologun dhe dialogun (prezantim me gojë dhe bisedë) ngaqë ishte e nevojshme të lidhet një periudh e gjatë kohore e historisë nacionale prej fundit të shekullit XVII deri me sot.

Vetëvlerësimi

Nxënësit japin të dhënat për vlerësimin e kualitetit të orës dhe arritjet që janë bërë në rrethin e vetëvlerësimit që është i ndarë në 4 pjesë, vlerësohet ligjerata, tema, atmosfera në orë dhe angazhimi i nxënësve, metoda e aplikuar. Nota e analizuar.







